

QEVERIA DERGON NE KUVEND PROJEKTLIGJIN E RI JA FORMULA E RE PER NDIHMEN EKONOMIKE

Zbardhet skema e re. Kush përfiton dhe kush përjashtohet. Si mund të veproni kur ju mohohet ndihma ekonomike. Përfitojnë edhe azilantët e mitur

► FAQE 15

FLET DAJA I VIKTIMES

"ADMIRI KREU VRASJE TE TREFISHTE, LA DY FEMIJET JETIME"

Gjykata mbyll në qeli gardistin që vrau gruan, Admir Dervishi njoftoi policinë pas kryerjes së vrasjes

► F16

PASTRIMI I PARAVE



GJIKNURI MBRON KOMPANITE OFF-SHORE, BB I DEL KUNDER

Ministri: Shumica e kompanive të hidrokarbureve nga parajsat fiskale, por janë të ligjshme

► F3

DUELI I FUNDIT RAMA-BLUSHI, MIMOZA HAFIZI FUSHATE ANTI- REFERENDUM

Sfida e Referendimit, duhet të marrin pjesë mbi 50 për qind

► F8



UDHEZIMI I RI

Procedura e aplikimit të dosjes së aplikimit për pajisje dhe leje zhvillimore në Regjistrin e Integruar të Territorit nga autoritetet vendore, në mbledhjet e pikës 2 dhe 3 të Vendimit nr.1 datë 30.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e përcaktimit e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shpërtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore".

Këshilli Kombëtar i Territorit më datë 30.07.2015 mori Vendimin Nr.1, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shpërtimin e kërkesave për leje ndërtimi-zhvillimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore", ku ndër të tjera vendosi:

(Pika) 2. Deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore, në zbatim sipas nenit 45, gërho b), të VKM-së nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar, autoritetet e zhvillimit të territorit lejohen të japin leje ndërtimi vetëm për këto raste përjashtimore:

Komente:

- Për NIQV me status **Bashki** (sipas ndarjes së vjetër administrative), dhe për të cilat kanë qenë miratuar Instrumentet e Planifikimit Vendor nga KKT, bëjnë me dije se nuk kanë nevojë për konformitet nga ana e AKPT-së, sipas nenit 45 gërmo a) të VKM-së nr.672 datë 29.07.2015 "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"
- Për NIQV me status **Komunë** (ndarje e vjetër administrative) dhe për të cilat mund të kenë pasur IPV të miratuar nga KKT, bëjnë me dije se duhet të marrin konformitet nga ana e AKPT-së.

KUSHTET E REJA PER LEJE NDERTIMI NE BASHKITE PA PLAN URBANISTIK

Si të përfshihen në 9 rastet përjashtimore që mundësojnë leje ndërtimi. Procedura për marrjen e lejes, gabimet që s'duhën bërë

NGA **ESIONA KONOMI**

► FAQE 10-11



DOSJET KANDIDATËT: KUSH PO E SABOTON KOMISIONIN

Kola: Presidentët, spiunë të Sigurimit të Shtetit

NGA **ADRIATIK DOÇI**

► F5



AUTOMJETET

BASHKEPUNOJNE ME AKUZEN LIROHEN 9 NGA TE NDALUARIT

NGA **ELTON QYNO**

► F7

KOÇO TASHKO AVANTAZHET E VITEVE TE MIA NE BASHKIMIN SOVJETIK

► F20-21

Prokuroria kërkon konfiskim të 3.7 mln euro të Ismailajt

Kastriot Ismailaj rrezikon të humbas pasurinë e tij, akuza i zbulon transfertat e dyshimta

ELTON QYNO
TIRANË

Biznesmeni i kompanisë DIA Kastriot Ismailaj, rrezikon të humbas 3.2 milionë dollarë dhe 450 mijë euro. Shuma është sekuestruar në bazë të ligjit "Antimafia" dhe se prej dy ditësh Prokuroria e Krimeve të Rënda ka dalë para gjykatës në konkluzionin se kjo shifër financiare duhet të konfiskohet dhe të kalohet në llogari të shtetit. Sipas akuzës këto para mendohet se janë vënë gjatë një procedure mashtrimi, që DIA ka ndjekur me kompaninë Çeke "Cez Shpërndarje" për mbledhjen e borxheve financiare tek konsumatorët. Prokuroria ka nisur hetimin mbi bazën e informacioneve të dërguara nga institucionet ligjzbatuese dhe akteve të një hetimi të mëparshëm të Prokurorisë së Tiranës. Në bazë të informacionit, kanë rezultuar dyshime se, nëpërmjet shoqërive të krijuara dhe administruara nga shtetasi Kastriot Ismailaj, janë kryer transaksione financiare pa logjikë ekonomike, me burime të ardhurash të dyshuara nga aktivitetet të paligjshme kriminale. Nga hetimet e zhvilluara në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal, ka rezultuar se shtetasi Kastriot Ismailaj është ortak apo administrator i disa shoqërive tregtare të regjistruara në Shqipëri, të cilat përgjithësisht nuk kanë



Detajet

FIKTIVE

Nga hetimet e zhvilluara në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal, ka rezultuar se shtetasi Kastriot Ismailaj është ortak apo administrator i disa shoqërive tregtare të regjistruara në Shqipëri, ku disa kanë aktivitet tregtar.


TRANSFERIMI

Transferimi është bërë duke e copëzuar shumën në pjesë të ndryshme, ku si përfutjes janë kompani dhe shtetas të ndryshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

aktivitet tregtar.

TRANSFERAT BANKARE

Sipas materialit hetimor, disa nga shoqëritë e të pandehurit janë "Adriatic Develop-



Kastriot Ismailaj

ment Corporation Ltd", Shoqëria AIC (Albania Investment Corporation) "Asset", Debt International, Advisory – Dega në Shqipëri"; dhe "VI Marketing Distribution". Disa nga këto kompani janë fiktive sepse nuk kanë zhvilluar aktivitet ekonomik. Në llogaritë e kompanisë "Adriatic Development Corporation Ltd" janë kryer transaksione financiare që shkojnë në miliona Euro. Nga verifikimi i dokumentacionit, nuk rezultoi se ekzistojnë dokumenta mbështetëse që justifikojnë transfertat e bëra, hyrëse apo dalëse, nga shoqëria "Adriatic Development Corporation" Ltd., si kontrata, fatura, marrëveshje, etj.

Gjatë periudhës 2006-2015 janë bërë transfertat hyrëse nga jashtë në shoqërinë "Adriatic Development Corporation" në vlerën 9,852,839.86

SEKUESTRIMI

Transferimi i parave, Ismailaj nuk bëri deklarime në tatime

Rezultoi gjithashtu se, megjithë transfertat e shumta dhe në vlera monetare të konsiderueshme, shoqëria nuk ka kryer deklarimet përkatëse në tatime, duke provuar se ato kanë qenë fiktive. Shumat, për të cilat Prokuroria për Krime të Rënda kërkon konfiskimin, aktualisht janë të sekuestruara fillimisht nga Prokuroria e Tiranës dhe më tej edhe nga Prokuroria për Krime të Rënda. Në momentin e sekuestrimit preventiv të kërkuar nga Prokuroria e Tiranës, gjendja e llogarive bankare në emër të të pandehurit Kastriot Ismailaj është sasia e parave që tashmë kërkohet të konfiskohet.

USD dhe 800.000 euro. Nga hetimi ka rezultuar se nuk gjenden dokumenta mbështetëse që të justifikojnë vlerat e arkëtuara. Gjatë

periudhës 2006-2015, për të gjitha transfertat dalëse nga shoqëria Adriatic Development Corporation në drejtim të individëve dhe shoqërive

të ndryshme nuk gjenden dokumenta mbështetëse që të justifikojnë vlerat e paguara. Si dërgues parash, rezultoi, ndër të tjera, edhe një kompani me qendër në Zvicër. Paratë e përfutur nga dërguesi i mësipërm në emër të Shoqërisë "Adriatic Development Corporation" Ltd, janë transferuar më pas jashtë vendit. Transferimi është bërë duke e copëzuar shumën në pjesë të ndryshme, ku si përfutjes janë kompani dhe shtetas të ndryshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Përshkrimet në transfertat dalëse janë trajtuar si pagesa për studime fizibileteti në projekte minierash, për shërbime ligjore, për shpenzime zyra, për konsulencë, por nuk rezultoi të jetë depozituar ndonjë dokument justifikues dhe në mënyrë të veçantë kontrata apo marrëveshje.



PROKURORIA HETON PËR PASTRIM PARASH "GFI TECHNOLOGIES"

Biznesmini Ismail Mulleti, i njohuri i familjes Berisha në transfertat Panamasë

Në skandalin e Panamasë është e përfshirë edhe Shqipëria. Bëhet fjalë për kompaninë e quajtur "GFI Technologies" i regjistruar në maj të 2013-ës në ishullin Anguilla, për të investuar në Shqipëri në kompanitë shqiptare të teknologjisë së lartë, kryesisht në ato të karburanteve. Haaretz.com ka mundur të zbulojë edhe emrin e njërit prej personave nga Shqipëria që bën pjesë në listën e "Panama Pa-

pers". Ish-kompania e markimit të karburanteve në Shqipëri i'u dha licenca nga ish-kryeministri Berisha në vitin 2013-në, ndërsa pas 2 vitesh, në 2015-ën, qeveria e re socialiste me kryeministër Edi Ramën, i hoqi licencën duke zgjidhur kontratën me këtë kompani. Në shkrim përmendet emri i një avokati të quajtur Assaf Halkin i cili së bashku me një shtetas shqiptar me emrin Ismail Mulleti dhe një firmë kanadeze 'Global

Fluids International S.A.', janë pronarët e kompanisë "GFI Technologies". Ismail Mulleti është një prej aksionerëve të "GFI Technologies", i cili njihet gjithashtu si ish ndërtues në Tiranë dhe njëherazi ish aksioner i një prej hoteleve më të mëdha në vend, Hotel "Tirana". Po sipas Bazës, Mulleti është një nga biznesmenët e afërt me Partinë Demokratike dhe familjen Berisha. Ai shkon edhe më tej kur pretendon se pas tij shihet

deputeti Genc Pollo dhe djali i ish kryeministrit Berisha, Shkëlzen Berisha. Sipas investigimeve të gazetarëve të huaj, bashkëpronare e shoqërisë "GFI Technologies" rezultoi Global Fluids International S.A.'. e cila në vitin 2013 mori në Shqipëri koncesionin e markimit të karburanteve. Kjo kompani në vitin 2015 ja shiti thujtë të tëra aksionet e kompanisë GFI Abania, partneres së saj "Petroleum Consulting Partners A.G.



Ismail Mulleti



BB kundër Gjiknurit: “Kujdes me parajsat fiskale”

Ministria e Energjisë: Shumica e kontratave hidrokarbure me shoqëri të regjistruara “off shore”, ligji s’i ndalon

GENC KONDI
TIRANE

Banka Botërore dhe Ministria shqiptare e Energjisë dhe Industrisë ndajnë mendime të ndryshme sa i përket dhënies së koncesioneve në sektorë strategjikë kompanive, aksionerët e të cilëve janë regjistruar në parajsat fiskale. Jo më larg se dje, ka patur një përplasje në distancë midis dikasterit dhe përfaqësuesve të zyrës së BB në Tiranë lidhur me qendrimit ndaj kësaj çështjeje.

MINISTRIA

“Në bazë të legjislacionit në fuqi, MEI nuk ka anjë të drejtë ligjore, që të vendosë kushte që kufizojnë vendndodhjen e aksionarëve të këtyre shoqërive

apo të drejtën e disponimit lirshëm të aksioneve. Është fakt i ditur që pjesa më e madhe e kontratave hidrokarbure në Shqipëri por edhe jashtë saj janë nënshkruar me shoqëri, aksionerët e të cilave janë të regjistruar në vendet e njohura si “off shore”. Ka qenë ky qendrimi i ministrisë së En-

ergjisë, si reagim ndaj lajmeve se qeveria sapo i ka dhënë një koncesion për kërkim e shfrytëzim të hidrokarbureve në pjesën verilindore të vendit, një subjekti që ka ndryshuar shumë herë pronarët për një kohë të shkurtër. Dhe ndër të cilët ka të regjistruar në Ishujt Virxhin britanikë.

Në njoftimin e ministrisë vihet gjithashtu në dukje se Bloku 8 është i pozicionuar në pjesën e verit të Shqipërisë, zonë për të cilën nuk ka patur asnjëherë më parë interes kërkimi nga kompani të tjera vendase apo të huaja për shkak edhe të mungesës së studimeve sizmike dhe rriskut të lartë të

kërkimit. Dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje nuk shoqërohet me shpenzime financiare për Buxhetin e Shtetit.

BANKA BOTËRORE

Ndërkohë, po dje, gjatë prezantimit të raportit të Bankës Botërore mbi zhvillimet e ekonomive në Evropën Juglindore, përfaqësuesja e BB në Tiranë, Tahseen Sayed, theksoi domosdoshmërinë për marrjen e masave ligjore për kompanitë koncesionare të regjistruara në parajsat fiskale. Sipas Sayed, Banka Botërore nuk është kundër procedurave të tilla, por ato duhet të jenë të studiuar mirë për risqet fiskale. Qeveria duhet të bëjë kujdes në dhënien e koncesioneve, duke analizuar risqet që ato sjellin për financat publike. “Si pikë fillimi, qeveritë duhet të vihen në lëvizje për të adresuar dhe kërkuar zgjidhjet e duhura ligjore për të reduktuar praninë e këtyre shoqërive. Është e rëndësishme të bëhet kujdes në dhënien e kontratave të partneritetit publik - privat veçanërisht në sektorë kyç, si infrastruktura. Është i rëndësishëm aspekti cilësor i tyre, si dhe aspekti fiskal, në mënyrë që të jenë të frytshme në vite”, tha Sayed. Banka Botërore deklaroi se nuk mund të japë këshilla për momentin lidhur me mënyrën se si duhet trajtuar “Panama Papers”, por, gjithsesi, njoftoi se në takimin e radhës në Uashington do të flitet edhe për këtë. Tahseen Sayed u shpreh se, për momentin, për Shqipërinë po monitorohet mënyra se si po e trajtojnë autoritetet këtë çështje. “Çështja këtu është se çfarë tregojnë rrjedhjet e dokumenteve dhe do duhet të shihet në qoftë se ka llogari, të cilat lidhen me kompani, individë dhe organizata të caktuara. Si pikë nisëse, është qeveria ajo, që duhet të trajtojë dhe vlerësojë çështjet ligjore dhe ato për sektorin bankar, sa i përket shkurtimeve ose uljes së krijimit të llogarive të tjera offshore që, siç e shohim, ka ndodhur mjaft shpesh në të gjithë botën”.

RAPORTI

Rritja

BB uli parashikimet për rritjen ekonomike të Shqipërisë këtë vit, nga 3.4, në 3.2%. Kryekonomistja e Bankës në Tiranë tha edhe se është llogaritur edhe një ulje e lehtë për vitin 2015, nga 2.7, në 2.6%

Varfëria

Efekti i rritjes tek familjet ka qenë modest, veçanërisht në uljen e varfërisë. Shqipëria po ecën ngadalë. “Tendencat rënëse e varfërisë është më e vogël se sa mesatarja e rajonit”, tha përfaqësuesja e BB

Reformat

Institucioni financiar ndërkombëtar rekomandon se reformat duhet të përqendrohen në përmirësimin e klimës së biznesit dhe qeverisjes, përmirësimin e drejtësisë, shërbimeve publike dhe mbrojtjes sociale



ÇMIMET / INSTAT: NË MUAJIN MARS RITJJA VJETORE ISHTE 0.3%

Inflacioni për të dytin muaj radhazi në nivel pranë zeros

Për herë të parë në shumë vite, indeksi i çmimeve të konsumit qëndron në nivelin pranë zeros për dy muaj me rradhë. Shqipëria ka si objektivi të inflacionit nivelin 3 për qind, me marzh plus minus 1 për qind. Kur inflacioni bie nën 2 për qind, atëherë BSH supozohet se ndërhyr për ta rritur atë dhe kur rritet mbi 4 për qind, BSH ndërhyr për ta ulur. Por, kur inflacioni është zero, kjo konsiderohet zakonisht si një dobësi e thellë në kërkesën konsumatore në ekonomi dhe sinjalizon rrezikun për një situatë deflacioniste, ku prodhimi, çmimet dhe konsumi, bien.

Sipas të dhënave nga Instituti i Statistikave, rritja e çmimeve për muajin mars ishte 0.3% me bazë vjetore krahasimi, ndërkohë që edhe për shkurtin inflacioni kishte qenë mjaft i ulët, në nivelin 0.2%.

Në konferencën për media të së mërkurës, guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, tha se inflacioni pranë zeros do të jetë kalimtar dhe përmendi si një ndër faktorët edhe bazën e lartë krahasuese me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar. Sipas guvernatorit, efekti i bazës së lartë krahasuese do të shuhet në muajin



prill dhe pritet që këtë muaj inflacioni së paku t’i afrohet intervalit të poshtëm të objektivit të Bankës Qendrore.

Por kryekonomistja e zyrës së Bankës Botërore në Tiranë, Hilda Shijaku, tha dje se rreziku deflacionist për ekonominë nuk mund të përjashtohet.

Rënia e fortë e inflacionit në muajt e fundit bëri që

Banka e Shqipërisë të ulte parashikimin për inflacionin mesatar vjetor në 1.9%, nga 2.2% që ishte projektioni i mëparshëm. Ky ishte edhe motivi kryesor me të cilin Këshilli Mbikëqyrës argumentoi ditën e mërkurë uljen e normës bazë të interesit në nivelin rekord minimal prej 1.5 përqindësh.

VENDIMI

Qeveria akordoi leje për një subjekt me origjinë të dyshimtë



Në mbljedhjen e fundit të qeverisë është miratuar kontrata me kompaninë “Albanides Energy” për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë në “Bllokun numër 8”, në verilindje të vendit. Shoqëria rezultoi në pronësi të “Dinaric International Energy”, një kompani e regjistruar në Ishujt Virxhin britanikë, një parajsë fiskale. Kontrata për “Albanides Energy” është transferuar disa herë, që prej negociimit, që nisi në vitin 2014. “Dinaric International Energy”, ka shitur për 90.000 USD aksionet dhe të drejtat një shoqërie kanadeze, e cila ia ka kaluar aksionet “Energulf Resources”.

REZIQET

Banka Botërore ka evidencuar pesë rreziqe që kanozin procesin e rimëkëmbjes të ekonomisë shqiptare. Nga faktorët e jashtëm, renditen tre si më kryesorë: luhatshmëria e tregjeve financiare, rritja më e ulët në tregjet eksportuese dhe lëvizjet e çmimeve të lëndëve të para në bursa. Ndërsa si arsye të brendshme shihen zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe shpejtësia e reformave strukturore dhe fiskale.

Programi për shëndetësinë, PD tryezë me mjekët

Tritan Shehu: PD ka një model ndryshe financimi

Partia Demokratike ka prezantuar dje pjesërisht programin për Shëndetësinë, me mjekë dhe specialistë në qytetin e Lushnjës. Kreu i Departamentit të Shëndetësisë, Tritan Shehu u shpreh se, shëndetësia sot vuan nga një centralizim dhe keqmenaxhim duke thelluar më tej krizën në këtë sektor. Sipas tij, në qendër të programit të Partisë Demokratike për sistemin shëndetësor do të jetë pacienti. Shehu tha se programi i PD përmban një model krejt ndryshe për financimin, specializimin e mëtejshëm të personelit dhe parashikon një decentralizim të menaxhimit të sistemit. "Është ajo që mund të quhet

"shëndetësi falas" në varfëri të thellë. Ky është problemi i parë. Mungon një perspektivë e rritjes së financimit në shëndetësi e cila është bllokuar nga slogani shëndetësi falas e cila është absurde. Së dyti ka të bëjë me menaxhimin, ku kemi të bëjmë me një centralizim të të gjitha veprimeve që kryen ky sistem shëndetësor. Kemi një keqpërdorim të buxheteve të financimit, edhe këto në mënyra të centralizuara, gjë që kanë thelluar varfërimin e sistemit tonë", tha Shehu. Sipas tij, në bazën e sistemit shëndetësor duhet të jetë pacienti. "Ne gjykojmë se në bazën e sistemit shëndetësor, në qendër të tij është pacienti, i cili duke qenë i lirë të zgjedhë

vetë ai mjekun, klinikën, spitalin, vë në lëvizje të gjithë sistemin duke i dhënë në këtë mënyrë dinjitetin e plotë personelit shëndetësor dhe institucioneve, duke i nxjerrë nga zinxhirët burokratike ku ndodhet sot i mbërthyer ky sistem", tha Shehu. Ai tha se një element tjetër është problemi që lidhet me personelin shëndetësor, me kualifikimet e tyre, specializimet, numrin e tij, mungesën e specialistëve, me faktin që specialistët e sistemit sot janë të diskriminuar, jo vetëm thjeshtë nga pagat qesharake që marrin por edhe nga mungesa e programeve, projekteve për specializimin e tyre, të realizimit të teknikave të reja, etj.

Financimi

"Mungon një perspektivë e rritjes së financimit në shëndetësi e cila është bllokuar nga slogani shëndetësi falas e cila është absurde. Së dyti ka të bëjë me menaxhimin, ku kemi të bëjmë me një centralizim të të gjitha veprimeve që kryen ky sistem shëndetësor".



Tritan Shehu gjatë takimit në Lushnje

Basha ndryshon kushtet për reformën, paralajmëron Fajon

Kreu i PD, Lulzim Basha: Nuk mund të ketë dialog pa standardet zgjedhore

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

A shtu si siç edhe paralajmëroi Shqiptarja.com, kryetari i opozitës Lulzim Basha ka formalizuar dje kushtet e reja për miratimin e reformës në drejtësi, me qëllim shtyrjen e votimit pas zgjedhjeve të 2017. Përpos dekriminalizimit dhe mandateve të dy deputetëve socialistë, Lulzim Basha e ka kushtëzuar votën për reformën në drejtësi, me garantimin e standardeve zgjedhore. Këtë qëndrim Basha e mbajti gjatë një takimi me eurodeputetin Tanja Fajon. Teksa është ngritur tashmë një komision për reflektimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR, Basha tha se zgjedhjet e lira janë jetike për Shqipërinë, duke lënë të kuptohet se standardet zgjedhore, do të jenë kushti i radhës. "Zgjedhjet e vitit 2015 u faktuan nga raporti i OSBE/ODIHR-it si jo të lira dhe të ndershme, u prova blejja e votave dhe intimidimi i votuesve. Kjo është konstatuar edhe nga përfaqësues të trupit diplomatik në qendra të ndryshme të votimit. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë jetike për Shqipërinë dhe për këtë kërkoi dhe ndihmën e eurodeputetes Fajon e cila ofroi mbështetjen e plotë duke i konsideruar zgjedhjet e lira të rëndësishme, pikë kyçe për një shtet demokratik", u shpreh Basha.

DEKRIMINALIZIMI

Në takimin me eurodeputeten, Basha e ka vënë theksin tek zbatimimi gërmë për gërmë të ligjit për dekriminalizimin. "Persona më të shkuar kriminale, si trafikant droge, qeniesh njerëzore etj, janë zgjedhur deputet, kryetarë bashkish, në poste të larta të administratës dhe Policisë së Shtetit. Për këtë, pas një vit diskutimesh e negociatash u miratua ligji për dekriminalizimin ndërsa nënvizoi se pa zbatimin jo vetëm në gërmë por në shpirt të këtij ligji, demokracia shqiptare është e rrezikuar e bashkë me të edhe stabiliteti



Lulzim Basha gjatë takimit me Tanja Fajon

i Shqipërisë", u shpreh Basha.

VENDIMET E GJYKATAVE

Kryetari i opozitës akuzoi shumicën në pushtet se nuk zbaton

vendimet e Gjykatës Kushtetuese. "Qeveria në mënyrë arrogante ka zhbërë ligjet konsensuale, refuzon të zbatojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ushtron presion ndaj

institucioneve të pavarura, medias etj, si dhe dhunon në mënyrë sistematike të drejtat e qytetarëve", tha Basha. Ai shtoi se implementimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Tanja Fajon

Gjatë vitit 2010, kohë kur Shqipëria përfitoi nga procesi i liberalizimit të vizave, Tanja Fajon ka mbajtur detyrën e Raportueses për Shqipërinë. Zonja Fajon ka luajtur një rol pozitiv në heqjen e vizave.

Kushtetëzimi

Përpos dekriminalizimit dhe mandateve të dy deputetëve socialistë, Lulzim Basha e ka kushtëzuar votën për reformën në drejtësi, me garantimin e standardeve zgjedhore.

TAKIMI

Kryetari i Partisë Demokratike pret delegacionin gjerman



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha priti në një takim deputetët e parlamentit gjerman, përfaqësues të partisë së kancelares Angela Merkel. Në takim, Basha ka theksuar se një model i ri, jo vetëm në Shqipëri por në Ballkan e më gjerë do të aplikohet për zgjedhjen e kandidatëve të rinj për deputet, duke nënvizuar vendimin e tij për t'i propozuar Këshillit Kombëtar që 35 % e kandidatëve për deputet të jenë të rinj. Sipas njoftimit të PD, Z. Basha ka marrë vlerësimet dhe mbështetjen e deputetëve gjermanë të CDU për lidhshimin e demonstruar në këtë standard të ri për demokracinë në Shqipëri, si dhe për betejën për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Po sipas njoftimit të PD, deputetët e Bundestagut kanë vlerësuar vizionin e zotit Basha dhe alternativën e tij për zhvillim ekonomik dhe punësim.

në asnjë vend demokratik nuk negociohet. Z. Basha tha se Partia Demokratike nuk tërhiqet dhe se pa zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ketë asnjë premisë për dialog të mirëfilltë politik. Partia Demokratike, tha Z. Basha qëndron fort për vlerat dhe parimet demokratike, Kushtetutën, zgjedhjet e lira dhe të ndershme, drejtësinë e pavarur dhe të pakapur që lufton dhe nuk mbron korrupsionin dhe krimin e lidhje qeveritare.



Kurt Kola

DEPUTETËT
Mes deputetëve dhe kandidatëve për anëtar të komisionit ka mosbesim. Secila palë do të tentojë përzgjedhë kandidatët më të afërt politikisht, për t'u besuar hapjen e dosjeve.

Hapja e dosjeve, kandidatët: Kush po e saboton komisionin

Kurt Kola: Presidentët, spiunë të Sigurimit të Shtetit

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Deputetët e Parlamentit Shqiptar po demonstrojnë qartazi mungesë vullneti për të finalizuar procesin e hapjes së dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit. Ndërsa ligji është miratuar që në datën 30.4.2015, përfaqësuesit e grupeve politike në Kuvend, nuk kanë konstituuar ende komisionin për hapjen e dosjeve, i quajtur ndryshe autoriteti Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Për bllokimin e këtij procesi sensitiv, por të domosdoshëm për ndarjen me të kaluarën komuniste, ka lëvizje, dyshime dhe tetori të shumta konspirative. Përpos të tjerave, pengesa kryesore sot për konstituimin e komisionit për hapjen e

dosjeve, janë ligjvënësit e dy kampeve politike, të cilët nuk japin 28 firma për kandidatët, për t'u mundësuar testimin me votë në Parlament.

KANDIDATËT

Po çfarë thonë vetë kandidatët? "Është vërtet që kanë kaluar afatet i konstituimit të autoritetit të informimit mbi dosjet e ish-Sigurimit. Vonesa erdhi për shkak të zgjatjes së certifikatave të sigurisë për aplikantët. Po kështu së fundmi u kërkuva dhe plotësimi i formulareve të dekriminalizimit të bazuar në ligj. Emrat e autoritetit, pasi aprovohen nga Komisioni i Ligjeve i kalojnë parlamentit për t'u votuar. Mendoj se ka një neglizhencë. Mendoj se ligji i hapjes së dosjeve i shërben konsolidimit të demokracisë. Koha është për të vepruar në mënyrë që mos të na ndjek nga pas hija e saj", shprehet Simon Miraka, kandidat për anëtar në komisionin për

Reagimi

Daut Gumeni, një tjetër kandidat, thotë se disa ligjvënës shqiptarë nuk janë të interesuar për hapjen e dosjeve, për shkak se preken disa funksionarë të caktuar.

hapjen e dosjeve.

KURT KOLA

Kryetari i Partisë "Rruga e Lirisë", Kurt Kola, u shpreh dje se, ka 25 vjet që qeverisemi nga spiunët, ndërsa tha se të implikuar janë edhe presidentët. "Ka 25 vjet që qeverisemi nga spiunët. Që nga viti '92 ka pasur mungesë

vullneti për të hapur dosjet. Arsyeya? Sepse të implikuar janë që nga drejtorët, deputetët deri tek presidentët", tha ai.

BLLOKADA

Burime pranë Kuvendit bënë me dije se, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministritë ka dorëzuar në Kuvend të gjithë dokumentacionin mbi rezultatet e verifikimit të kandidatëve për anëtarë të komisionit për hapjen e dosjeve. Dosja e referuar nga DSIK, sipas burimeve, u mundësonte të gjithë kandidatëve të garojnë. Por, kandidatëve u mungojnë 28 firmat. Gjithsesi, kandidatët, të pyetur për këtë çështje, për t'u mos armiqësuar me deputetët, tregohen të kujdesshëm. "Jo nuk besoj se ka vështirësi për firmat. Se maxhoranca që ka aprovuar ligjin ka marrë miratimin e deputetëve të sajë së bashku me aleatët. Mund të jetë vonesa edhe për shkak të përzgjedhjes", pohon Miraka.

Hapja e dosjeve, garancitë për spiunët e Sigurimit

Ligji ndalon publikimin e informacionit të fshehtë

Ligji për hapjen e dosjeve parashikon disa garanci të forta për bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, çka do të vështirësojnë zbulimin e emrave të spiunëve, të cilët mbajnë funksione publike. Neni gjashtë i ligjit, parashikon ndalimin e dhënave personale në dem të personave të prekur apo palëve të treta, kur këto të dhëna janë përfutur në mënyrë të fshehtë apo të paligjshme, me përjashtim të të përdorimit për qëllime rehabilitimi të personave të vdekur apo të zhdukur. Ky parashikim pritet të krijojë një konflikt mes mediave dhe komisionit, i cili do të vihet nën presion nga ish-bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit. Sipas

ligjit, autoriteti merr masa për ndalimin e përkohshëm të përdorimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, kur prokuroria ose gjykata përcakton se nga përdorimi i tyre mund të dëmtohet veprimtaria hetimore, ndjekja penale, ecuria ose përfundimi i një procedimi penal të regjistruar. Po ashtu, autoriteti merr masa për ndalimin e përkohshëm ose të përhershëm të të dhënave të ish-Sigurimit të Shtetit, kur gjykon se përdorimi i tyre mund të përbëjë rrezik real për sigurinë kombëtare. Po ashtu, ligji parashikon rregulla dhe burokraci të stërholluara për marrjen e informacionit. Ndërkaq, nëse Autoriteti konstaton, gjatë përbushjes së

detyrave të veta, se në dokumente gjenden informacione për spiunazh, kundërspiunazh ose terrorizëm, në kuptimin e legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë, njofton me iniciativën e tij autoritetet përgjegjëse të inteligjencës dhe sigurisë. Gjatë diskutimeve në komisionet parlamentare, ligjvënësit kanë treguar një kujdes të veçantë sa i takon neneve për të drejtën e informimit.



Dokumentet

Autoriteti lejon përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas parashikimeve të ligjit, kur ato nuk përmbajnë të dhëna personale mbi të prekur apo palë të treta.

DOKUMENTET

Si do të mblidhen dosjet e Sigurimit të Shtetit



Të gjitha autoritetet publike dhe rrjeti arkivor janë të detyruara me ligj për të mbështetur komisionin në kërkimet e tij për gjetjen e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe në mblidhjen e tyre. Kur autoriteti publik ose arkivi është në dënjëni apo konstaton, gjatë përbushjes së detyrave, se zotëron dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit apo kopje ose dublikata të tjera të dokumenteve të tilla, vë menjëherë në dënjëni komisionin. Sipas ligjit, komisioni vlerëson se dokumente të caktuara mund të gjenden pranë një autoriteti publik apo arkivi, u drejtohet atyre me kërkesë me shkrim për identifikimin dhe vënien në dispozicion të dokumenteve. Komisioni, në mirëkuptim me autoritetet publike dhe arkivat, mund t'i shqyrtojë regjistrimet, arkivat dhe informacionet që gjenden tek tu, kur ekzistojnë të dhëna të besueshme se pranë tyre gjenden dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

Verifikimi

Kandidatët për deputetë do verifikohen

Komisioni për hapjen e dosjeve do të verifikojë kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkëish dhe kryetarë këshilli qarku, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit. Kërkesa mund të bëhet prej tyre për qëllime të transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale, por edhe nga institucionet e parashikuara në ligj. Në këto raste, autoriteti informon për personat që në periudhën e përcaktuar gjurojnë si anëtar ose kandidat i Byrosë Politike,

anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor,



Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit etj. Ky ligj është kontestuar nga segmente të opozitës dhe të shoqërisë civile, por gjithsesi, sipas mazhorancës, ky është ligji më i miri mundshëm, i mbështetur në modelin gjerman.

STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION" sh.p.k NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 2 PËR:

"Truall, sipërfaqe 300 m² nga kjo 110 m² ndërtesë, Zona Kadastrale: Nr.3502, Numri i Pasurisë: 58/145, Vol. 9, Faqe 206 e regjistruar ne Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Spiten, Komuna Zejmen - Lezhë, hipotekuar në favor të FAF sha., me vlerë **2 064 496 (dy milionë e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **04.05.2016, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarrimore "SPEED SOLUTION" sh.p.k me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla. 1, Kati, 2. N.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni cel.0693041355; 0696334695; e-mail: speed.solution@yahoo.com

Veliaj: Familjet e përmbytura nga shirat tashmë kanë shtëpizë të vogël

Në Ditën Ndërkombëtare të Romëve, kryebashkiaku i Tiranës, inspektoi parkun



Gjetja e zgjidhjeve për strehimin e komunitetit rom mbeten ndër objektivat kryesorë të Bashkisë së Tiranës. Në Ditën Ndërkombëtare të Romëve, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erjon Veliaj, inspektoi nga afër punën që po bëhet për ngritjen e parkut të rullove për banorët e komunitetit rom, të cilët u përmbytën gjatë shirave të muajit janar në Bregun e Lumit. I shoqëruar nga ambasadorja e Hollandës në vendin tonë, Dewi van de Weerd, përfaqësuesi i UN-it, Brian Williams dhe drejtuesit të Ecovolis, Ened Mato, kryebashkiaku Veliaj vizitoi dje ambientet e parkut, si dhe bisedoi me banorët që do të

strehohen aty, duke u njohur me problematikat që shoqërojnë jetën e këtij komuniteti. Veliaj vlerësoi se falë punës dhe angazhimit edhe të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, një pjesë e komunitetit rom do kenë tashmë një strehë të përhershme ku do mund të jetojnë. “Më vjen mirë që në një situatë, e cila me shirat e fundit u bë dramatikë, ku shumë anëtarë të komunitetit rom ishin vulnerabël prej përmbytjeve dhe u strehuan në këto kabanone për çështje të emergjencës, sot kanë një shtëpizë të vogël, modeste, por të sigurt, të ngrohtë, jashtë të gjitha reziqeve që mund të sjellë moti e natyra. Besoj se tani, hapësirat që u përdorën për

emergjencat, mund t'i kemi për çdo situatë tjetër”, tha Veliaj. Ai shprehu mirënjohjen e tij për të gjithë vullnetarët që u angazhuan dhe punuan për të mundur ngritjen e këtij parku, si dhe përkujdesin që tregojnë ndaj këtij komuniteti. “Unë besoj se kur punojmë të gjithë bashkë, ne mund të bëjmë gjëra që veç e veç janë të pamundura”, theksoi kryetari i Bashkisë së Tiranës. Ndërkohë, ambasadorja holandeze Dewi van de Weerd u shpreh e surprizuar që brenda një kohe të shkurtër u bë një punë e madhe dhe për këtë ka shprehur falenderimin për të gjithë aktorët e angazhuar. “Do të doja të falenderoja komunitetin që jeton këtu, që bashkë

me Ecovolis morën përgjegjësinë për ta kthyer këtë në një kamp të vërtetë ëndërrash. Po ashtu, dëshiroj të falenderoj Bashkinë e Tiranës e cila dha kontributin e saj në këtë nisim. Përgëzimet e mia për këtë”, përfundoi ajo. Kurse, Ened Mato, përfaqësuesi i Ecovolis, shtoi se dita e sotme është një mundësi për të dhënë një dorë dhe për të gjetur zgjidhje konkrete për një komunitet si familjet romë. “Ky park reflekton dashuri, edhe për mjedisin rrotull. Jam i lumtur sepse arritëm deri këtu, por jemi 30% e punës, kështu që kemi akoma punë përpara dhe jemi të vendosur që këtë ta bëjmë parkun më të bukur në botë”, u shpreh Mato.



VIDEO/ VELIAJ DUKE INSPEKTUAR PARKUN E RULOETEVE



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

TIRANË / KRYETARI VELIAJ KA LAJMERUAR NISMEN

Hapet për herë të parë për publikun vila e ish-diktatorit

Cdo qytetar do të ketë mundësi të shuajë kërshtërinë e tij për të mesuar se si jetonte ish-diktatori, pasi këtë muaj, ish-rezideca e Enver Hoxhës në kryeqytet, pritet të hapet për publikun, për herë të parë. Këtë e ka bërë të ditur sot, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erjon Veliaj, gjatë dëgjësës publike që zhvilloi për planin e ri urban të Tiranës. “Shpresoj që përvëç “Resë”, në muajin prill, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, të hapim atë që njihet si vila e Enver Hoxhës në ish-Blok. Besoj se shfrytëzojmë disa hapësira që mund të kenë qenë tabu apo qeveritare, me shërbime të kufizuara, duke i hapur për publikun dhe krijuar këto lloj “qelizash” në të gjithë qytetin që mund të gëlojnë si nga jeta ekonomike, ashtu edhe nga jeta kulturore”, deklaroi Veliaj. Ai foli edhe për projekte të tjera si ai i sheshit Skënderbej, Unaza e vogël, ndërtimi i kopshteve e shkollave, gjelbërimi, etj. Veliaj bëri me dije se projekti për tarracat e gjelbra pritet të nisë së shpejti në zonën



e 21 Dhjetorit. Këtë mandat parashikojmë të mbjellim 50 mijë pemë, por në këtë proces duhet të përfshijë edhe privatën, u shpreh ai, teksa shtoi se “investimet publike janë vlerë e shtuar për komunitetin”. Për të spjeguar këtë,

kryebashkiaku solli edhe shembullin e investimeve të zona e “Pazarit të Ri”, që sipas tij, kanë sjellë edhe rritjen e çmimeve të banesave në këtë zonë, duke iu referuar agjencive imobiliare. Ai iu përgjigj edhe ankesave të ndërtuesve

se Bashkia nuk po jep leje ndërtimi: “Lejet e ndërtimit kanë ndikim te punësimi, unë e di, por ato duhet të jepen me karar”. Së fundmi, Veliaj u shpreh se është i gatshëm për debat lidhur me planin e ri urban të Tiranës.



Gara

Dibra: Rishikojmë programet Universiteti jo më vendi i qokave

Kandidatja për Rektore të Universitetit të Tiranës Klodeta Dibra ka prezantuar platformën e saj para studentëve dhe pedagogëve. Ajo u shpreh se Universiteti i Tiranës duhet të konkurojë me universitetet e Europës, duke qenë se ka një histori shumëvjeçare. Dibra theksoi se Universiteti më i rëndësishëm në Shqipëri, nuk do të jetë më vendi i qokave. “Universiteti i Tiranës, universiteti më i madh, universiteti më i vjetër universiteti që vitin e ardhshëm mbush 60 vjeç unë besoj se duhet të përfaqësojë dhe të konfirmojë qenësinë e tij si krenaria dhe lideri i gjithë universiteteve në Shqipëri dhe hapësirën shqiptolëse. Si tempulli i dijes, si tempulli i debatit por unë them jo më tempulli i qokave jo më vendi përfitimeve dhe jo më vendi i gënjeshtrave.” Gjithashtu Klodeta Dibra premtoi se do të rishikohen një pjesë e programeve të studimit për t'u përshtatur me tregun e punës. Në zgjedhjet për që do të zhvillohen në 20 prill, kandidon për Rektor të Universitetit të Tiranës edhe Mynyr Koni, i cili e ka shtrirë fushatën e tij në diskutimet me pedagogët e studentët.

Bashkëpunojnë me akuzën lirohen 9 nga të ndaluarit

Vjedhja e makinave luksoze, prokuroria: Tuna jo pjesë e grupit. Burg vetëm për dy organizatorët

ELTON QYNO
TIRANE

Nëntë nga të arrestuarit e operacioni "Lux" në Shkodër pritet lenë qelitë e paraburgimit, kjo si pasojë e bashkëpunimit me prokurorinë e Shkodrës, duke treguar të dhëna të hollësishme lidhur me veprimtarinë e grupit që vidthe në vendet e Bashkimit Europian dhe më pas i trafikonte makinat e shtrenjta në Shqipëri, duke përdorur një sërë dokumenta të flasfikuara. Nëntë nga 11 të arrestuarit kanë treguar për prokurorët e çështjes një sërë veprimesh kriminale, të cilat i kryente kreu i këtij grupi Bujar Hasa dhe një person tjetër edhe ky i fundit i arrestuar. Bashkëpunimi me grupin hetimor ka sjellë dhe zbutjen e masës së sigurisë për 9 të ndaluar, ku pritet që ditën e diele prokuroria të kërkojë masën "detyrim paraqitje". Ndërkohë për Bujar Hasën dhe një person tjetër do kërkohet masa e "arrestit në burg". Hetimet për identifikimin e këtij grupi kanë zbuluar se pjesë e këtij rrjeti ka qënë dhe një shtetas tjetër, që rezultoi të ketë vdekur. Mes

BABAI I TUNËS

Lidhur me arrestimin e Lekë Tunës, ka reaguar për "Shqiptarja.com" dhe babai i zyrtarit të arrestuar, Anton Tuna, i cili ka pohuar se djali i tij nuk ka gisht në vjedhjen e makinave dhe shitjen e tyre nëpërmjet dokumentave të flasfikuara.

personave të arrestuar me urdhër të prokurorisë është dhe shtetasi Lekë Tuna, i cili rezultoi të jetë shefi i agjensisë së OSHEE në Kurbin.

TUNA JO PJESË E GRUPIT

Burime pranë prokurorisë së Shkodrës thanë se shefi i agjensisë së OSHEE në Kurbin Lekë Tuna, nuk ka lidhje me anëtarët kryesore të këtij grupi kriminal. Tuna në këtë rast ka blerë një automjet tek shtetasi Bujar Hasa, dhe se më pas ka rezultuar se ky automjet është i vjedhjes. Nisur nga kjo situatë, gjatë ditës së djeshme mes Tunës dhe Hasës janë bërë ballafaqime, ku Tuna ka treguar me detaje të gjitha veprimet që ka kryer me Bujar Hasën. Ndërkohë lidhur me arrestimin e Lekë Tunës, ka reaguar për "Shqiptarja.com" dhe babai i zyrtarit të

MASA SIGURIMI

Bashkëpunimi me grupin hetimor ka sjellë dhe zbutjen e masës së sigurisë për 9 të ndaluar, ku pritet që ditën e diele prokuroria të kërkojë masën "detyrim paraqitje". Ndërkohë për Bujar Hasën dhe një person tjetër do kërkohet masa e "arrestit në burg".

arrestuar, Anton Tuna, i cili ka pohuar se djali i tij nuk ka gisht në vjedhjen e makinave dhe shitjen e tyre nëpërmjet dokumentave të flasfikuara.



Makinat e sekuestruara

Sipas tij, spekulimet që janë bërë nga partia demokratike janë disformuese dhe është për të ardhur keq, që një parti kaq e madhe bën prononcime të tilla.

SI FUNKSIONONTE GRUPI

Bujar Hasa, një person që njihet në Shkodër si tregtar makinash është arrestuar, teksa është provuar implikimi i tij në një grup kriminal që trafikonte mjete motorike. Hasa, si kreu i këtij grupi kishte ngritur një "zinxhir kriminal" ku persona të ndryshëm vidhnin për logari të tij automjete luksoze në vende të ndryshme të Bashkimit Europian dhe në vendet e Ballkanit, dhe më pas ia shisnin ato Hysës. Ky i fundit në bashkëpunim dhe me një shtetas nga Mali i Zi, kishin ngritur në prapavijë dhe një industri të plotë falsifikimi, duke filluar nga falsifikimet me numrat e shashisë për mjetet luksoze të vjedhura,

dokumentat e tyre e shumë, veprime të ndryshme. E gjithë procedura kryhej në servise të ndryshëm, kuptohet kundrejt një pagese financiare, ku numrat e shashive të makinave të ligjshme dhe të përdorura në vendet e Bashkimit Europian, injektoheshin duke u vendosur në numrat e shashive të makinave të vjedhura. Më pas Bujar Hasa, tashmë i arrestuar dhe me 15 persona të tjerë, arrinte t'i fuste këto automjete nga pika e kalimit kufitar Hani i Hotit, duke përdorur si ndihmë disa punonjës të policisë pranë kësaj pike doganore. Më tej pasi makinat hynin në Shqipëri procedura shkonin zinxhir, duke filluar nga zhdoganimi i mjeteve, rregjistrimi i tyre në Drejtorinë e Qarkullimit Rrugor, e deri tek veprimet e Hysës me persona të tjerë, duke nënshkruar kontrata shiteje noteriale, mbi bazën e dokumentave që kishte falsifikuar.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST CONSULTING SERVICES

ENHANCING QUALITY OF FINANCIAL REPORT PROJECT

Consulting Service-Firms Selection

For
Technical assistance in filing and publication of statutory financial statements
AL-EQ-FINREP/III.2/CS/CQ

ALBANIA

Project: Enhancing Quality of Financial Report (EQ-FINREP)

Project ID: P152567

Assignment Title: Technical assistance in filing and publication of statutory financial statements

Ref. No: AL-EQ-FINREP/III.2/CS/CQ

The Government of Albania has received financing in the amount of 1.850.000 Euro equivalent from the World Bank toward the cost of the Enhancing Quality of Financial Reports Project (EQ-FINREP), and it intends to apply part of the proceeds to payments for consulting services for "Reform international strategic consultant".

Corporate financial reporting is an important element of developing the Albanian market and its role is growing, along with the corporate sector development and an increase in direct foreign investment. The findings of World Bank diagnostic assessment - Accounting and Auditing Report on the Observance of Standards and Codes (A&A ROSC) in 2006 has led towards need for programmatic approach to enhance the financial reporting in Albania. Based on the recommendations of the 2006 A&A ROSC, the Country Action Plan to Enhance Corporate Financial Reporting in Albania (CAP) was adopted in February 2009. SC. The first phase of CAP has been implemented during The Corporate Financial Reporting Enhancement Project, which has contributed in improvement of legal and institutional framework for financial reporting in Albania. Beside achievements of CFREP, still there are match to be done to enhance the financial reporting in Albania. Further legal changes are required in audit law to achieve full compliance with the EU *acquis communautaire*. Ensuring adequate funding and institutional arrangements for audit oversight and quality assurance remain also a critical issue and further improvement of audit methodologies and techniques is needed.

Under this assignment the selected Consulting Company is expected to: review the Albanian legislation to identify the possible gaps with EU legislation in the disclosure and filing of the financial statements and other related reports, i.e. audit report, management report; prepare an assessment of current status in filing and disclosure of financial statements and providing proposals for its improvement based on the good European/international practices; design an upgraded system for filing and disclosure of financial statements, accompanied with technical specifications, cost estimation and application guidelines; and prepare a dissemination of the information about the new filing system emphasizing its benefits.

The Central Finance and Contracting Unit in the Ministry of Finance of Albania invite eligible Consulting Companies to indicate their interest in providing the Services.

Short listing criteria are

- At least 5 year's experience in providing legal and financial consultancies to build the capacities of public entities/institutions.
- At least 5 year's experience in providing legal and financial consultancies in drafting of legal acts (laws and by-laws) and institutional processes and procedures
- At least 4 key project team member, with necessary qualifications and experience to run and manage the assigned project. The Consultant staff engaged on this assignment should have the following qualifications:
 - Legal Expert: with at least 5 years of professional experience in reengineering of regulations and processes, as well as capacity building of public institutions, as well as being fluent in English and Albanian.
 - Financial Reporting Expert, with at least 5 years of experience and expertise in preparing and disclosing financial statements/audit reports, as well as being fluent in English and Albanian.
 - IT Expert: with at least 5 years experience and expertise in designing functional specifications and development of software applications, including technical specifications for hardware implementation, as well as being fluent in English and Albanian.
 - PR Expert with at least 3 years of experience and expertise in awareness campaigns and organization of public launch events, including promotion through TV as well as other promotion channels, as well as being fluent in English and Albanian.

The maximum effort level is 200 working days spread during the project implementation period up to 12 months.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's *Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014)* ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with the Consultant's Qualification method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays.

The complete Terms of Reference is posted on the website of CFCU: <http://cfcu.minfin.gov.al>.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail within April 25th, 2016.

Manol Simo, General Director
Central Finance and Contracting Unit (CFCU)
Ministry of Finance
Bldv: Dëshmorët e Kombit, No. 3, Tirana, Albania
Tel: +355 4 24 51 180
E-mail: manol.simo@financa.gov.al

Opozita sulmon Lekë Tunën

PD: Një trafikant makinash në krye të OSHEE në Kurbin

Deputeti i Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj, ka ekskuar dje se në krye të OSHEE për Kurbinin është emëruar një trafikant makinash. Deputeti tha se bëhet fjalë për kreun e një grupi kriminal, i cili vidthe makina. "Lekë Tuna është kreu i një grupi kriminal që vidthe dhe trafikonte makina, e pikërisht me Edi Ramën u shpërblye duke u bërë drejtori i OSHEE për Kurbinin. Pas një hetimi të gjatë të prokurorisë së Shkodrës ky person u arrestua natën e 5 prillit, nën akuzën e trafikimit të mjeteve motorrike. Por lajmi po mbahet i fshehtë, dhe megjithëse nën arrest për këtë veprë



të rëndë penale, Tuna vazhdon të jetë zyrtarisht kreu i OSHEE për Kurbinin"-thotë deputeti i PD. Sipas tij, inkriminimi i institucioneve nuk ndalet dhe pasurimi i zryave me trafikantë vazhdon me të njëjtat ritme. "Ndërsa Edi Rama kreket me presionin ndaj të pamundurve, banda e tij në OSHEE vazhdon të dhunojë qytetarët, vazhdon të shtojë radhët me kriminelë me damkë. Në gjithë Kurbinin, mes qindra të rinjve e të rejave, burrave e grave me integritet e të arsimuar, Edi Rama i vuri gishtin pikërisht këtij vjedhësi dhe trafikantit makinash, kreut të një grupi të strukturuar kriminal, me lidhje dhe me mafian rajonale, për të besuar drejtimin e OSHEE", deklaroi Alibeaj.

■ ULSI MANJA

"Më vjen vërtet keq që fatura e kafes së Blushit në Dibër është një kortezi për partinë e Saliut dhe që Blushin me Lulin sot në Dibër nuk e dallon dot kush."

■ SHKELJA

"Referendum në shkelle të panumërta të Statutit e Kodit të PS. Referendum pa fushatë e pa asnjë shpjegim për ju, nga nismëtarët e organizatorët!"

Sot dueli Rama-Blushi Hafizi fushatë anti-referendum

Sfida e referendumit, duhet të marrin pjesë mbi 50 për qind të anëtarësisë në votim

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Partia Socialiste, subjekti më i madh politik në vend, pritet t'i japë sot fund një debati disa javor për legjitimitetin e mandatit të kryetarit, Edi Rama. Pas shumë polemikash dhe akuzash, 81,572 anëtarë të Partisë Socialiste do të votojnë sot për konfirmimin ose jo të mandatit të Edi Ramës. Që referendumit të konsiderohet i vlefshëm, duhet të marrin pjesë më shumë se 50 për qind të anëtarëve. Referendumi u propozuar nga kryeministri Rama, propozim i cili u miratua në Kongresin e fundit

të Partisë Socialiste. Edhe pse një mundësi për të testuar secila palë mbështetjen, referendumit u kontestua nga deputeti Ben Blushi, i cili ka shprehur ambicien për postin e kryetarit të Partisë Socialiste. Sipas deputetit Blushi, referendumit ishte i paligjshëm, ndërsa ka shprehur dyshime të forta për trukim. Në këtë kuadër, deputeti Blushi dhe deputetja Mimoza Hafizi kanë nisur një fushatë kundër referendumit, duke u bërë thirrje anëtarëve të Partisë Socialiste që të mos marrin pjesë në votim. Gjithsesi, ky referendum pritet të shndërrohet sot në përballjen e fundit mes Edi Ramës dhe Ben Blushit. Votimi i sotëm pritet t'i japë fund duelit mes kryeministrit dhe

sfidantit të tij, për postin e kryetarit të PS dhe kryeministrit. Sipas të gjitha gjasave dhe shenjave, deputeti Blushi do të shkojë drejt një parti të re, e cila mund të zyrtarizohet në muajt në vijim. Nga ana tjetër, Edi Rama pritet të fokusohet tek sfida e zgjedhjeve të 2017, për të siguruar një mandat të dytë qeverisës.

■ HAFIZI

Deputetja Mimoza Hafizi, e identifikuar tashmë si mbështetëse e linjës së Ben Blushit, u ka bërë dje thirrje anëtarëve, që të mos marrin pjesë në referendumin për mandatin e kryetarit. Hafizi ka shprehur edhe dyshime për manipulim. "Proces referendar me diferencë prej mijëra



Edi Rama (djathtas) Ben Blushi dhe Mimoza Hafizi

njerëzish mes numrit të votuesve në lista dhe numrit të votuesve të deklaruar nga selia e PS. Proces me një sërë shkeljesh të cilat i kemi denoncuar e do vazhdojmë t'i denoncojmë në ditët vijuese. Mos u bëni pjesë e kësaj farse! Mos lejoni t'ju përdorin! Mos i besoni premtimeve për punësim në këmbim të një vote! Mos u frikësoni! Jepini vetes dinjitetin që duan t'ju nëpërkëmbin", shkruan Hafizi. Deputetja u ka bërë thirrje socialistëve të denoncojnë manipulimet. "Vigjilioni e denoncoji çdo tentativë për manipulim në këtë votim! Çështja e Partisë Socialiste është e juaja, ajo lidhet drejtpërdrejt me fatin e familjes suaj, fëmijëve tuaj,

me jetën e çdo shqiptari, anëtar apo jo i PS", shkruan Hafizi.

■ REFERENDUMI

Mimoza Hafizi thotë se, referendumit nuk u shërben socialistëve dhe qeverisjes së vendit. "Referendumi që ju kërkohet të dilni e të votoni nesër nuk zhvillohet për asnjë nga shqetësimet tuaja. As për një qeverisje më të mirë, as për vende pune e paga më të larta, as për shëndetësi e arsim më të mirë, as për administratë profesionale e të përkushtuar, Jo! As për më tepër demokraci në organizatën tonë politike, as për karrierë të merituar partiake, as për më tepër punësim në radhët tuaja, Jo", shkruan zonja Hafizi.

TAKIMET/ REFERENDUMI NE PS NJE SHENJE DEMOKRACIE

Nikolla e Balla: Merrni pjesë në votim, procesi transparent

Ndryshe nga Blushi dhe Hafizi, ministrja Lindita Nikolla dhe deputeti Taulant Balla u kanë bërë thirrje dje socialistëve që të marrin pjesë masivisht në referendumin e sotëm. Dy funksionarët e Partisë Socialiste kanë theksuar se vendimmarrja e sotme është madhore. "Është një ushtrim demokracie sepse nuk ka ndodhur në asnjë parti në Shqipëri pluraliste që të ftohet anëtarësia e saj, përmes procesit një anëtar një votë, për të dhënë verdiktin e saj në një vendimmarrje kaq madhore të një force politike. Ndaj jepini rëndësinë e duhur, duke punuar fort që në referendumin e 9 prillit", u shpreh Nikolla. Zonja Nikolla ka bërë apel për një pjesëmarrje të plotë. "Pjesëmarrja të jetë e plotë e gjithë anëtarëve, gra apo vajza në fshat apo në qytet, gjithë anëtarësia e vjetër apo anëtarët e rinj të Partisë Socialiste, të shprehin me votë mendimin e tyre për këtë vendimmarrje, kaq të rëndësishme të Partisë Socialiste, jo thjesht si rezultat i procesit referendar, por si një ushtrim të mirëfilltë demokracie, që ndodh për

Përfaqësuesit e PS thirrje anëtarëve të votojnë për kryetarin

herë të parë në këto 25 vite të Shqipërisë pluraliste", tha ajo. Ndërkaq, deputeti Taulant Balla ka folur për një

proces transparent. "Listat e zgjedhësve në çdo qendër votimi janë shpallur prej disa ditësh. Gjithashtu, të gjitha komisionet e votimit kanë marrë dokumentacionin, fletët e votimit dhe procesverbalet. Është bërë një punë e shkëlqyer për sa i përket njoftimit të të gjithë anëtarësisë. Apeli im sot për çdo anëtar të PS të Qarkut Elbasan, Qarkut Korçë dhe të të gjithë Shqipërisë është që, në këtë ushtrim demokratik

brenda PS, çdo anëtar duhet të marrë pjesë", tha Balla. Sipas Ballës, ky referendum është shenjë demokratizimit. "Për ne nuk është i rëndësishëm rezultati se si do të shprehet anëtarësia në këtë referendum, por e rëndësishme është pjesëmarrja e çdo socialisti për të treguar që ky Referendum i parë, në një parti politike shqiptare, në këto 25 vjet, është një shprehje e demokratizimit të PS", tha Taulant Balla.



Taulant Balla



Lindita Nikolla

REAGIMI

Reagon Kryeministri Rama: Sot ditë e shënuar, merrni pjesë

Kryeministri Edi Rama u ka bërë dje thirrje anëtarëve të Partisë Socialiste që të marrin pjesë pasivisht në referendumin e sotëm, për mandatin e kryetarit të partisë. Rama ka theksuar se sot është një ditë e shënuar për Partinë Socialiste. "Nesër një ditë e shënuar për PS që pyet anëtarësinë me referendum. Pjesëmarrja e çdo anëtarit kontribut për forcimin e demokracisë në PS", shkruan Rama. Ndërkaq, deputetët e Partisë Socialiste dhe ministrat janë angazhuar këto ditë në zonat e tyre, për të mobilizuar anëtarësinë, për të marrë pjesë në votimin e sotëm, për mandatin e kryetarit. Pjesëmarrja e socialistëve në votim do të jetë përcaktuese për fundin e debatit për mandatin e kryetarit.



AKUZA

Ben Blushi: Kutitë janë mbushur në ditë para votimit

Ben Blushi ka deklaruar se kutitë e votimit për referendumin e sotëm janë mbushur një ditë para. Sipas Blushit, në këtë referendum, asnjë socialist i vërtetë nuk e gjen emrin në lista. "Një referendum ku asgjë nuk është reale dhe normale. Ku kutitë e votimit janë të mbushura pa filluar ende votimi. Një referendum ku socialisti i vërtetë nuk e gjen emrin ose më saktë ku nuk ka lista zgjedhësisë", u shpreh Blushi. Nga Dibra deputeti Ben Blushi ju bëri thirrje të gjithë socialistëve të denoncojnë të gjitha parregullsitë e referendumit të nesërm të montuar të Edi Ramës. Ai sërish akuzoi Ramën si shkaktarin kryesor të kësaj referendumi të PS dhe grabitjen e mandatit nga një referendum i stisur.

DENIS MINGA
TIRANË

Refendumi i së shtunës për mandatin e kryetarit do të jetë një referendum edhe për mënyrën e qeverisjes së Partisë Socialiste. Kështu ka deklaruar Sekretari Organizativ, Blendi Klosi, i cili ishte i ftuar në emisionin "45 minuta" nga Denis Minga në Report TV. Ai u shpreh i bindur se pjesëmarrja do të jetë shumë e lartë. I pyetur për akuzat e Blushit për manipulim të referendumit, Klosi tha se ky proces do të jetë tërësisht transparent. Ai foli edhe për aleancën me LSI, ku deklaroi se koalicioni ka bërë një punë të shkëlqyer por shtoi se ende nuk është vendosur nëse dy aleatët do të shkojnë së bashku në zgjedhje.

Është caktuar data për mbledhjen e Asamblesë?

Ende nuk është caktuar si datë. Por do të mbledhet shumë shpejt për të zgjedhur kryesinë, sekretariatën e partisë. Do të jetë vota e anëtarëve të Asamblesë që do të zgjedhë këtë pozicione.

Po për Sekretarin e Përgjithshëm?

Me statutin e ri, posti i kryetarit të Asamblesë do të ketë edhe postin e Sekretarit të Përgjithshëm të PS. Gjithashtu, kemi edhe disa ndryshime të tjera me statut. Si forcë politike nuk jemi vetëm një parti elektorale, por jemi edhe një parti e cila ka një strukturë të përgjithshme. Dhe opinioni i saj, njëzëzë të saj, duhet të mbledhet në një strukturë të vetme. Ndaj, Sekretari i Përgjithshëm, sekretari do të jetë i papërpunshëm me funksione administrative.

A do të jetë kjo një garë mes Kokëdhimës dhe Ruçit?

Ju doni të merreni me emra të përveçëm, por duke qenë anëtar i vjetër i forumeve të kësaj partie, dua të mbroj partinë time. S'kam marrë pjesë dhe as kam qenë ndonjëherë palë me një grup kundër një grupi tjetër. Për momentin s'ka asnjë garë të brendshme brenda partisë për këto pozicione. Situata brenda PS është shumë harmonike.

Dhe kaq harmonike nuk është, se p.sh. referendumi po sulmohet nga një pjesë e PS. Z.Blushi thotë se e kemi manipuluar pa filluar...

Edhe ky grup kolegësh, nuk e kundërshton idenë e referendumit. S'ka asnjë politikën me zhërvjedhtësi që ta kundërshtojë. Referendumi është një risi e propozuar nga z.Rama. Ai ka disa risi e të mira, nuk është thjesht si do t'i përgjigjen pyetjes. Ky është një rezultat i cili kemi bindjen që do të ketë një mbështetje masive. Një nga risitë e statutit është forca e madhe që i jepet anëtarit të thjeshtë. Do të pyeten edhe për mënyrën e funksionimit të strukturave, do të pyeten çfarë mendimi kanë për deputetin, si po ecën reforma në territorin e vendit. Ne po tojtonjë të shkojmë 150 mijë vetë anëtarë të PS. Nuk shkojmë me 150 mijë anëtarë në 12 qershor, për të patur një listë anëtarësie, por për të patur një parti që të ketë të dhëna për çdo person, për të patur fushën e interesit që ai mbulon, profilin, emailin, nr e telefonit të tij. Pra, e gjithë anëtarësia e PS të jetë online dhe në pyetshmëri të vazhdueshme. Kjo do të jetë pyetja e parë, në vijim të disa pyetjeve për marrje mendimesh deri në ditën e zgjedhjeve.

Futet në kaos PS nëse nuk kalon 50%?

Sipas ligjit, duhet të shprehet mbi 50% e listës së anëtarësisë. Nëse nuk prisni se do të marrin 41 mijë anëtarë, atëherë unë nuk jam



Blendi Klosi i ftuar në emisionin "45 minuta" nga Denis Minga në Report TV

Klosi: Referendumi nesër, edhe për mënyrën se si kemi qeverisur

"Nëse nuk ka pjesëmarrje 50%, unë nuk do të jem më në politikë"

më në politikë.

Për Edi Ramën do të shkojnë kaq shumë? Pse duhet të shkojnë?

Sigurisht. Po pse, për kë? Nëpërmjet referendumit kuptohet mbështetja që i jep anëtarësia forumit më të lartë, që është Kongresi. Ky referendum është një vlerësim për mënyrën sesi ne po qeverisim, sesa qeverisja e Edi Ramës po realizon premtimet tona në këto 2 vite e gjysmë. Ata që votojnë nesër janë anëtarë të PS, për të dëshmuar mbështetje për qëndrimet e PS dhe leadershipin e PS. Kjo është një arsye më shumë për të dalë nesër masivisht në votime. Ky është një ushtrim organizativ i partisë, që do të thotë se ne kemi një numër të regjistrit të anëtarësisë aktive, kemi pas-truar listat dhe kjo anëtarësi është aktive sot. Referendumi ka shumë arsye që do t'i nxjerrë nesër në votim.

Akuzat e z.Blushi, flet për manipulime, kuti të mbushura dhe për numrin 81 mijë apo 94 mijë...Thotë se është ulur numri për të rritur këtë 50%-ësh...

Nuk janë akuzat, por hipoteza se sipas tij pritet që nesër të manipulohet. Gjëja s'ka ndodhur. Dhe se çfarë them unë apo kolegët e mi, ka rëndësi për një grup të vogël. Për opinionin publik, procesi i votimit do të jetë i gjithi transparent. Kjo është edhe një ftesë, në çdo qendër votimi vendosni një kamera dhe ndiqni procesin. Në 11 minibusitë e Tiranës, do të ketë 11 qendra votimi.

Jeni nga të paktët socialistë që i përkasin PS-së së parë dhe PS-së së dytë... politikani i vjetër në PS. Z.Blushi thotë se ka PS dhe Riilindje. Është e njëjta gjë, apo dy gjëra të ndryshme?

Kam 20 vite si anëtar dhe 17 vite si anëtar i forumeve të larta në PS. Nuk jam në këtë emision që t'i përgjigjem një kolegu socialist. Jam këtu për t'iu përgjigjur pyetjeve që kanë lidhje me PS. Ndaj, i bëj thirrje socialistëve të thjeshtë që marrin nesër në votim, për të treguar mbështetjen për vendimarrjen e PS dhe punën e qeverisë. PS ka rritur që gjeneratat të përcjellin njëra-tjetrën me disa vlera e parime. Ky grupim shoqëror dhe këta njerëz që e bëjnë PS-në, nga s'është senatorë, gjenerata e parë e PS, mund të ketë një gjeneratë

të dytë, dhe mund të themi se ka një gjeneratë të tretë e të katërt. Në vendimarrjen e PS, ka përfaqësues nga të gjitha gjeneratat dhe prandaj jemi të fortë.

PS është më demokratike në drejtimin e z.Rama, apo më pak, në krahasim me para 2005?

PS nuk është as e Fatos Nanos e as e Edi Ramës. PS nuk është parti e individit, por e parimeve dhe anëtarëve të thjeshtë të PS. Nuk gjej në eksperiencën time që të ndryshojë mënyra e vendimarrjes dhe mënyrë si pyesim njëri-tjetrin. Referendumi është një mënyrë shumë e mirë për të marrë mendimin e anëtarësisë. Një njeri që është kundër kësaj, atëherë shkon dhe voton kundër nesër. Në 2005-ën PS ka patur metoda dhe funksion tjeër, sot ka metoda dhe funksion tjetër.

Kur kryetari jep dorëheqjen, që nga 97-a e deri tani PS s'ka dalë e dytë, ju e keni vënë në statut që kryetari jep dorëheqjen kur del parti e dytë...

Vetëm në PS kryetari ka dhënë dorëheqjen, me Fatos Nanon.

Në 2009-ën, ishit parti e parë, por humbët zgjedhjet...

Thamë të hapen kutitë. Edi Rama tha se nëse nuk kam fituar, jap dorëheqjen. Sali Berisha s'i hapi.

Ju s'i fitoni zgjedhjet pa aleatët...

Del parti e parë, është fituese. Nëse shkon me aleatë, bën 71 vota, është parti fituese.

Si janë marrëdhëniet me LSI. Me kë do të shkoni në zgjedhjet e 2017?

Jemi në një qeverisje shumë të mirë, me rezultate spektakolare, të paarritura më parë, me reforma të thella ku s'kemi parë asnjëherë përplasje mes forcave brenda koalicionit.

Përpiqemi të ruajmë atë që kemi thënë kur kemi bërë marrëveshjen. Forcat politike janë dy në bazë të të drejtave të marra me marrëveshjen.

Kur kemi bërë marrëveshjen, kur t shkojmë në zgjedhje, s'do shkojmë të themi si kaluam me aleatët, por do të kërkojmë mandat për reformat që kemi bërë.

Nëse këto reforma që ka iniciuar Edi Rama, janë reforma që janë sjellë të mira për qytetarët, do të rimarrim votat. Do të raportojmë për punët që kemi bërë sëbashku me aleatët qeverisës.

Sesi do të jetë formula, nuk është momenti. Këtë pyetje po t'i abëni Edi Ramës dhe Ilir Metës, do të të japin të njëjtën përgjigje.

S'do të ketë zgjedhje të parakohshme?

Pse duhet të ketë zgjedhje? Mazhoranca e propozoi, e negocioi të gjithë thonë votojeni, ata s'e votojnë. Po gjykoj për rëndësinë e reformës në drejtësi.



STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION" sh.p.k NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 2 PËR:

Arë me sipërfaqe 4000 m², Zona Kadastrale Nr.1247, Nr.Pasurise 214/16, Vol.5, Faqe.212 me vendndodhje Borizanë Krujë, me vlerë **338 240 (treqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e dyzet) Lekë**, hipotekuar në emër të FAF sh.a.

Pemtores me sipërfaqe 5990 m², Zona Kadastrale Nr.1475, Nr.Pasurise 270/11, Vol.4, Faqe.245 me vendndodhje Derven Krujë, me vlerë **1 187 424 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e njëzet e katër) Lekë**, hipotekuar në emër të FAF sh.a.

Ankandi do të zhvillohet më datë **05.05.2016, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore "SPEED SOLUTION" sh.p.k me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla. 1, Kati, 2.Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni cel.0693041355; 0696334695; e-mail: speed.solution@yahoo.com


DOKUMENTACIONI I NEVOJSHEM PER LEJE NDERTIMI

- a) kërkesa për leje ndërtimi, sipas formularit tip
- b) dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;
- c) fragmenti i hartës së parcelës/ave ku do të kryhet zhvillimi, l rilevuar nga topograf licencuar;
- ç) plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;
- d) projekti teknik arkitektonik dhe i peizazhit, sipas rasteit, në 2D dhe 3D, përfshirë eliminimin e barrierave arkitektonike;
- dh) projekti konstruktiv
- e) projekti i instalimeve që përfshijnë ato hidrosanitare, elektrike, ngrohje, ventilim, mbrojtje nga zjarri, eficientë energjetike, shkallë emergjence;
- ë) grafiku paraprak i punimeve dhe afati i dorëzimit të objekteve, sipas fazave të zbatimit;
- f) preventivi;
- g) deklaratat e projektuesit të licencuar, sipas shtojcës B, për përputhshmërinë e projektit me dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në fuqi dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare;
- gj) lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm sektorial, sipas rasteit;
- h) mandatpagesa/t e tarifës/tarifave të aplikimit, për të gjitha proceset e shërbimit me një ndalesë.

BASHKITE
 "Për NJQV me status Bashki (sipas ndarjes së vjetër administrative), bëjmë me dije se nuk kanë nevojë për konformitet nga ana e AKPT-së"

BASHKITE PA PLAN ZHVILLIMI

- Lezhë
- Kurbin
- Krujë
- Kukës
- Dibër
- Durrës
- Vorë
- Shijak
- Kavajë
- Rrogoshinë
- Divjakë
- Ura Vajgurore
- Poliçan
- Skrapar
- Gjirokastrë
- Vlorë
- Himarë
- Sarandë
- Konispol
- Librazhd
- Përrenjas
- Cërrik
- Pogradec
- Korçë
- Tiranë
- Shkodër



Lirohen ndërtimet në bashki penalizohen ish-komunat

Për leje ndërtimi në ish-komunat, konfirmim në AKPT

ESIONA KONOMI
 TIRANE

Kush kërkon një leje ndërtimi në njësinë administrative bashki, e ka më të thjeshtë ta marrë atë, krahasuar me dikë që kërkon leje ndërtimi në ndonjë ish-komunë. Sipas një vendimi të

muajit mars të Këshilli Kombëtar të Territorit, në rastet kur ndërtimi kërkohet të bëhet në ish-komuna, atëherë do të duhet konfirmim nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Në fund të këtij vendimi të KKT-së, janë bërë dy saktësime që i takojnë kësaj kategorie. "Për NJQV me status Bashki (sipas ndarjes së vjetër administrative), dhe për të cilat kanë qënë miratuar

Instrumentet e Planifikimit Vendor nga KKT, bëjmë me dije se nuk kanë nevojë për konformitet nga ana e AKPT-së, sipas nenit 45 gërma a) të VKM-së nr.672 datë 29.07.2015 "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit". Për NJQV me status Komunë (ndarja e vjetër administrative) dhe për të cilat mund të kenë pasur

të miratuara nga KKT, bëjmë me dije se duhet të marrin konformitet nga ana e AKPT-së"-thuhet në vendim. I njëjti vendim përcakton procedurat e ngarkimit të dosjes së aplikimit për pajisje me leje zhvillimi/ndërtimi në Regjistrin e Integruar të Territorit nga autoritetet vendore. Këshilli Kombëtar i Territorit më datë 30.07.2015 mori Vendimin "Për përcaktimin e rregullave dhe

DOKUMENTET / SI PLOTESOHEN DOSJET

Procedura për lejen e ndërtimit, gabimet që s'duhën bërë

Pas depozitimit të dokumentacionit nga aplikuesi pranë sportelit të shërbimit, autoriteti i zhvillimit verifikon nëse dokumentacioni është i plotë brenda 5 ditëve nga paraqitja e tyre. Brenda këtij afati shqyrton: Identitetin e nënshkruarit dhe faktin nëse është person i legjitimuar për të paraqitur kërkesën; Plotësimin e plotë dhe të saktë të gjithë të dhënave të detyrueshme të formularit të kërkesës për leje zhvillimi/ndërtimi; Paraqitjen e të gjitha dokumenteve shoqëruese të detyrueshme si dhe pagesën e shërbimit/aplikimit. Autoriteti vendos mospranimin e kërkesës nëse nuk përmbush një nga përcaktimet e mësipërme. Nëse do-

kumentacioni i domosdoshëm është i plotë atëherë autoriteti i zhvillimit vijon me hapjen e dosjes ligjore dhe ngarkimin e tyre në Regjistrin e Integruar të Territorit (RIT) sipas hapave të mëposhtme. Së pari, bëhet plotësimi i Formularit të kërkesës për leje zhvillimi/ndërtimi me të dhënat që përmban dosja për zhvillimin e propozuar. Pasi plotësohet, formulari siglohë nga autoriteti përgjegjës i planifikimit, protokollohet dhe skanohet. Numri i protokollit do të shërbejë dhe si numër referencë për hapjen e dosjes ligjore në RIT. Në Regjistrin e Integruar të Territorit, duhet të bëhet hapja e dosjes ligjore për kërkesën e paraqitur për zhvil-

limin e propozuar, përkatësisht tek nja "Akte Ligjore". Për krijimin e dosjes së re vijohet me plotësimin e të dhënave si: Numri i dosjes ligjore, i cili duhet të jetë numri i protokollit me të cilin u protokollua Formulari i Kërkesës për Leje Zhvillimi/ Ndërtimit; Data, e cila do të jetë data e regjistrimit të kërkesës për zhvillim në RIT; Titulli i dosjes ligjore, duhet të jetë ai i projektit i shkruar në formularin e kërkesës; -Statusi i dosjes. Deri në miratim të kërkesës për leje, statusi do të jetë "Në shqyrtim". Pas marrjes së vendimit nga kryetari i NJQV-së, statusi do të jetë "Në fuqi"; -Institucioni, i cili e miraton këtë kërkesë për zhvillim.



Këshilli Kombëtar i Territorit

PROCEDURA
 Deri në miratim të kërkesës për leje, statusi do të jetë "Në shqyrtim". Pas marrjes së vendimit nga kryetari i NJQV-së, statusi do të jetë "Në fuqi"; -Institucioni, i cili e miraton këtë kërkesë për zhvillim.



PERJASHTIMET
 Punime të infrastrukturës quhet çdo zhvillim i ri, me investim publik ose privat, për ngritje rrjetesh shërbimi ose sigurie publike, të rrjetit elektrik, rrjeteve të ujësjellësit, të kanalizimit etj

BASHKITE JAPIN LEJE NDËRTIMI VETEM PER KETO RASTE PERJASHTIMORE:

- a) punime të infrastrukturës;
- b) struktura publike;
- c) ndërhyrje me karakter emergjent;
- d) struktura me funksion prodhues, industrial, përfshirë këtu ato me material porositës;
- dh) struktura me funksion turistik;
- e) struktura në funksion të prodhimit, përpunimit dhe distribucionit të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- ë) banesa individuale/njefamiljare, kërkuar nga pronari i truallit për strehimin primar të tij me sipërfaqe totale ndërtimi deri në 250m²;
- f) shtesa në banesa individuale/njefamiljare ekzistuese, deri në masën 50% të sipërfaqes së tyre totale të ndërtimit.

procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi-zhvillimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore, ku ndër të tjera vendosi që deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore, autoritetet e zhvillimit të territorit lejohen të japin leje ndërtimi vetëm për këto raste përjashtimore: punime të infrastrukturës; struktura publike; ndërhyrje me karakter emergjent; objekte për interes publik, shtetëror dhe kombëtar; struktura me funksion prodhues, industrial, përfshirë këtu ato me material porositës; struktura me funksion turistik; struktura në funksion të prodhimit, përpunimit dhe distribucionit të produkteve bujqësore dhe blegtorale; banesa individuale/njefamiljare, kërkuar nga pronari i truallit për strehimin primar të tij me sipërfaqe totale ndërtimi deri në 250m²; shtesa në banesa individuale/njefamiljare ekzistuese, deri në masën 50% të sipërfaqes së tyre totale të ndërtimit.

Kushtet e reja për leje ndërtimi në bashkitë pa plan urbanistik

Si të përfshihen në 9 raste përjashtimore që mundësojnë leje ndërtimi në 26 bashki

ESIONA KONOMI
 TIRANE

26 bashki të vendit janë pa plane zhvillimore dhe nuk mund të japin leje ndërtimi me përjashtim të 9 rasteve të specifikuar në vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit. Por Agjencia Kombëtare e Territorit në vendimin e zbardhur specifikon se cilat kushte duhen përbushur nga një aplikues për tu përfshirë në një nga këto 9 raste përjashtimore që mundësojnë lejen e ndërtimit. Dokumenti i përgatitur nga AKT, i quajtur "Akti i Konformitetit" përcakton raste. Punime të infrastrukturës quhet çdo zhvillim i ri, me investim publik ose privat, për ngritje rrjetesh shërbimi ose sigurie publike, të rrjetit elektrik, rrjeteve të ujësjellësit, të kanalizimit, të ngrohjes, të telefonisë, internetit, të kanaleve të kullimit apo kanaleve të ujitjes, leje të sinjalistikës rrugore etj, nga operatorë publik/privat që ofrojnë apo synojnë ofrimin e shërbimeve publike/private sipas legjislacionit në fuqi. Struktura publike quhet struktura, sipas përkufizimit të Ligjit të Planifikimit të Territorit, të financuara nga fonde publike. Ndërhyrje me karakter emergjent përfshihen të gjitha objektet që paraqesin rrezik shembje me pasojë për jetën, shëndetin e njerëzve, pasurinë e të tregëve apo që paraqesin dëmim serioz të konstruksionit dhe funksionit të strukturës/ave ekzistuese, objekte që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, të vërtetuara nga raportet teknike të ekspertëve dhe rastet pasojë e forcave madhore apo rasteve të njësuara me to.

Objekte për interes publik, shtetëror dhe kombëtar janë objekte që janë të nevojshme për realizimin e objektivave / interesave të vendit (arsim, shëndetësi, kulturë, ekonomi, ushtri etj.) apo për kryerjen e investimeve strategjike, me mbështetje private ose publike. Struktura me funksion prodhues, industrial, përfshirë këtu ato me material porositës janë çdo zhvillim i ri, me investim publik ose privat, nga subjekte publike/private që ofrojnë apo synojnë ritjen e prodhimit industrial në vend, sipas legjislacionit në fuqi. Struktura me funksion turistik janë sipas rregullave, kritereve dhe përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi në fushën e turizmit. Struktura në funksion të prodhimit, përpunimit dhe distribucionit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, bëhen referuar strukturave të përcaktuara në VKM, Nr.283, "Për përcaktimin e tipeve, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore", i ndryshuar. Banesa individuale/njefamiljare, kërkuar nga pronari i truallit për strehimin primar të tij me sipërfaqe totale ndërtimi deri në 250m² – në këtë rast sipërfaqe totale ndërtimi nënkupton sipërfaqen totale mbi tokë të objektit, referuar përcaktimeve të VKM Nr. 408, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", e ndryshuar. Shtesa në banesa individuale/njefamiljare ekzistuese, deri në masën 50% të sipërfaqes së tyre totale të ndërtimit – në këtë rast sipërfaqe totale ndërtimi nënkupton sipërfaqen totale mbi tokë të objektit, referuar përcaktimeve të VKM Nr. 408, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", e ndryshuar.

Përgjigja
Afati i marrjes së lejes vetëm 45 ditë

Pavarësisht e kanë apo jo një plan rregullues, të gjitha bashkitë janë të autorizuar për të dhënë leje për qëllime strehimi apo biznesi. Ndryshimi i vetëm është që për objektet mbi 6 katëshe, kërkesat do të shqyrtohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Por kjo nuk do të zbejë kompetencat e kryebashkiakëve, pasi fjala e fundit do t'u takojë atyre. E njëjta praktikë do të ndiqet edhe për lejet e ndërtimit përgjatë vijës bregdetare. Lidhur me aplikimet online, çdo qytetar i interesuar për leje ndërtimi mjafton të futet në portalin "eAlbania", duke ndjekur opsionin "eshërbime". Aty do të shfaqet një tabelë, e cila duhet të plotësohet me të dhënat personale të aplikantit. Në tabelën përmbëri janë të listuara edhe dokumentet që kërkohen. Pas dërgimit të kërkesës, qytetari do të informohet mbi ecurinë e saj. Në sajë të këtij sistemi të ri do të bëhet i mundur edhe shkurtimi i kohës për marrjen e lejes, nga 60 ditë që ka qenë në 45 ditë.

PORTALI/ PËR TË KRYER APLIKIMIN, QYTETARËT DO TË REGJISTROHEN NË E-ALBANIA

Nga 20 prilli, aplikimi për leje ndërtimi do bëhet edhe online

Duke filluar nga data 20 prill, për të marrë leje ndërtimi mund të aplikohet online në portalin e-Albania. Vendimi më i fundit i Qeverisë parashikon që procedura e aplikimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të bëhet edhe në mënyrë elektronike. Sipas Ministrisë së Zhvillimit Urban, nga data 20 prill deri më datë 31 gusht

2016, qytetarët mund të vijnë në të aplikojnë në të dy mënyrat: në rrugë elektronike dhe në formë shkresore. Ndërsa, duke filluar nga data 1 shtator 2016, aplikimi, shqyrtimi dhe miratimi i lejeve do të kryhet vetëm përmes sistemit elektronik. Vendimi i qeverisë parashikon gjithashtu se afati i shqyrtimit për lejet e ndërtimit nga bashkia është 15 ditë, ndërsa institucionet e tjera që duhet të japin mendimin e tyre në lidhje me lejen duhet të përgjigjen brenda 10 ditëve pune. Në rast se institucionet publike nuk i japin përgjigje bashkisë brenda 10 ditëve pune, miratimi i tyre konsiderohet i dhënë në heshtje dhe bashkia mund të vijnë më tej me shqyrtimin e aplikimit. Në çdo rast të mungesës së përgjigjes nga



Faksimile e portalit online "e-Albania"

bashkia brenda 60 ditësh nga dorëzimi i kërkesës së aplikuesi, sistemi gjeneron vendim për miratimin në heshtje. Sistemi do të kryejë përlogaritjen automatike të afateve të shqyrtimit të kërkesës dhe do të evidentojë dhe informojë nëpunësit për vonesat e mundshme. Për të kryer aplikimin, qytetarët do të regjistrohen në portalin e-Albania.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë menaxher marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Të ketë arsim të lartë
- Të ketë përvojë pune
- Të jetë i gatshëm për të punuar në terren

Personat e interesuar të dërgojnë CV e tyre në adresën: marketing@shqiptarja.com



Pamje nga operacioni në liqenin e sShkodrës



Jastëk me ajër për të nxjerrë helikopterin

Polumbarët e RENEA, gjejnë orën e pilotit Deliaj. Moti i keq ndërpreu operacionin

DASHAMIR BIÇAKU
TIRANE

Zbardhen detaje të reja nga hetimet për rrëzimin e helikopterit të ushtrisë, për shkak të të cilit mbetën të vdekur, dy pilotët kapiten Floran Deliaj dhe toger Donald Hoxha, si dhe u plagos ushtari Gerald Baramuçi. Burime të grupit të hetimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Policisë së Shtetit thanë se nga hetimi është ngritur dyshimi se helikopteri është rrëzuar nga një problem në motorin e tij. Burimet thanë se ky dyshim është ngritur bazuar në kqyrjen e helikopterit por edhe në dëshmitë e marra në vendin e ngjarjes. Ekspertët kanë ngritur dyshimin se ky problem ka shkakuar edhe mosfunksionimin e helikopterit, e përbërë kryesisht me fibër karboni. Po kështu sipas burimeve, është përjashtuar deri në këtë moment të hetimit, gabimi njerëzor i pilotëve. Sipas helikopterit ka nisur të humbë lartësi dhe kur ka qenë afërsisht 20 apo 30 metra mbi liqen, ai është mënjeluar. Në këtë kohë ushtari profesionist Gerald Baramuçi është hedhur nga helikopteri ndërsa ai ka vuar të fluturojë për inerci edhe shumë metra më tej.

JASTËKËT E AJRIT

Ndërkaq të premtën dhe të shtunën ekspertët e ushtrisë dhe të policisë, kanë bërë një përpjekje për të nxjerrë helikopterin me jastëkë ajri, ose me një helikopter tjetër. Ky proces është bllokuar nga kompania "Eurocopter" gjatë ditës së premte, me qëllim që ata të jenë të pranishëm gjatë kqyrjes dhe gjatë procesit të nxjerrjes dhe gjatë veprimeve të tjera ekzaminuese. Ndërkaq gjatë kësaj të shtune që e pamundur kryejra e veprimeve në ujë, për shkak të dallgëve të liqenit dhe më pas për shkak stuhisë që shpërtheu. Ndërkaq gjatë kërkimeve dhe kontrolleve të kryera gjatë këtyre dy ditëve, nga ekspertët e Policisë dhe Ushtrisë është bërë e mundur të nxirret nga fundi i Liqenit e një ndenjeseje që ishte e zhytur në thellësi,

dhe e disa pjesëve të tjera të helikopterit. Ato kanë qenë kryesisht veshje fibrash, apo pjesë të tjera të shpërndara të helioikopterit në një perimetër prej rreth 60 metrash. Po kështu ekspertët kanë pohuar se helikopteri ndodhet i përmbytur në liqen

me helikën poshtë dhe me sllat mbi ujë. Mes sendeve të gjetura, grupi hetimor ka administruar edhe orën e dorës së Floran Deliaj, e cila sipas burimeve edhe tri ditë pas aksidentit e tregonte kohën me saktësi.

SHIU, NDËRPRET OPERACIONIN

Polumbarët e RENEA-s dhe Foracave të Armatosura, kanë nxjerrë këtë të premte nga Liqeni i Shkodrës, mbetjet e helikopterit të Ushtrisë EC 145, të rrëzuar dy ditë më parë. Puna

për nxjerrjen e helikopterit filloi mëngjesin e djeshme me matjet dhe vetëm rreth orës 17:00 është bërë e mundur nxjerrja e disa prej pjesëve të mjetit fluturues. Burime nga vendi i ngjarjes kanë bërë me dije se është arritur të nxirret një pjesë e motorit si dhe dy

sedile. Ndërkohë, për shkak të kushteve atmosferike që u përkeqësuan në mesditë, nuk është arritur të nxirret kutia e zezë dhe trupi i helikopterit, që ka mbetur nën ujë. Pjesët e nxjerrja u dërguan në komisariatit e Shkodrës. Bëhet e ditur se operacionet e kërkimit janë ndërprerë për ditën e djeshme, për shkak të kushteve të vështira atmosferike. Polumbarët e RENEA-s dhe Forcave të Armatosura, pritet të rinisin punën sot. Nga të dhënat që do të nxirren prej kutisë së zezë pritet të zbadhen edhe shkaqet e aksidentit ku humbën jetën dy pilotët, ndërsa një i ushtar mbeti i plagosur.

RRËZIMI/ HELIKOPTERËVE U MUNGONJË 2 KUTITË E QUAJTURA "KITE" TË SERVISIT Kompania "Eurocopter" nuk ka sjellë kutitë e servisit



Kuti kite për servis

Rrëzimi i helikopterit në ujrat e liqenit të Shkodrës, ka risjellë edhe një herë në vëmendje të mospërmbyshjes me korektësi së kontratës nga kompania Franceze "Eurocopter". Mësohet se dy nga helikopterët ushtarakë që kjo kompani ka prodhuar për Forcat Ajrore Shqiptare, u mungojnë kutitë e servisit të quajtura "Kite". Një paisje të tillë mësohet të mos e ketë patur dhe helikopteri i rrëzuar dy ditë më parë në Shkodër, i cili në fakt ka mbëritur i fundit në Shqipëri, duke hyrë në inventarin e ministrisë së Mbrojtjes.

Funksioni i këtyre kiteve shërben për kryerjen e shërbimit servisit, gjatë kohës kur helikopteri është në ajër. Kutia e servisit është e ngjashme me një lap-top dhe ka në përbërje kaqavida, pinca dhe një paisje elektronike për të mësuar anomalitë e helikopterit që mund të ketë gjatë fluturimit. Një burim i tha gazetës "Shqiptarja.com" se vlera e këtyre kiteve kushton më mijëra euro dhe se blerja e këtyre paisjeve ka qenë e parashikuar në kontratë, megjithëse ato nuk kanë mbëritur të plota në regjimentin e Parkës.

KONTRATA/ 79 MILION EURO PËR 6 HELIKOPTERËT ME PROBLEME

U firmos me Francezët për "PO"-në në NATO



Automjeti i ngarkuar me pjesët e helikopterit

Njëri nga helikopterët e rrëzuar në Shkodër është blerë nga kompania franceze "Eurocopter", dhe se ka hyrë në Shqipëri në muajin nëntor 2015. Modeli "EC-145" është brenda garancisë kontraktuale dhe se ministria e Mbrojtjes ka të drejtë të kërkojë një tjetër helikopter të ngjashëm si ai që u shkatërua dhe në liqenin e Shkodrës. Marrëveshja me kompaninë është miratuar nga qeveria "Berisha" më 4 shkurt të vitit 2010, dhe se u ngarkua ish-ministri Imami për mbikqyrjen e kësaj marrëveshjeje. Sipas marrëveshjes, qeveria shqiptare do të blinte 5 helikopterë nga kompania, ndërsa në atë kohë u tha se kjo kishte

ardhur si kusht i Francës, në mënyrë që ajo të thoshte fjalën "PO" për pranimin e Shqipërisë në NATO. Marrëveshja do të zbatohet për një periudhë 4 vjeçare, pra deri në fund të vitit 2013. Në atë kohë, kontrata ishte për helikopterë të llojit "AS 532 AL COUGAR" nga versionet ushtarake të familjes Super PUMA, që do të thotë për terrene të vështira. Shuma për blerjen e këtyre helikopterëve të cilësuar si super modernë ishte 78 milionë euro gjithsej. Vlera ishte e lartë për një vend të vogël si Shqipëria, por shifra nuk vihej në diskutim nga qeveria "Berisha" përpara faktit të futjes së shqipërisë në aleancën e NATO-s.

Manjani: Gjykatat të mos bëhen pengesë për kreditë e këqija

Ministri u ka tërhequr vëmendjen gjyqtarëve gjatë analizës vjetore

Në fjalën e tij gjatë analizës vjetore të Gjykatës së Apelit ministri i Drejtësisë Ylli Manjani preku si një ndër çështjet kyç dhe problematike atë të kredive të këqija. Ai tha se Gjyqësori duhet të lejojë përbarimin të ekzekutivëve vendim dhe jo t'i blloktojë me procedura. "Shumë shpejt do t'i propozojë qeverisë një paketë ligjore, i cili përforcon rolin e përbaruesit, pasi mesazhi është ky: kush ka marrë kredi duhet ta kthejë pas, kokërr më kokërr. Vërtet marrëveshja është private, por interesi është publik. Nuk kemi ndërmend të cedojmë, sepse mund të ketë pasoja më vonë. Çështja e kredive të këqija duhet adresuar me përparësi. Si çdo titull ekzekutiv tjetër, duhet zbatuar. Ptesa ime është: ju lutem të lejojim përbarimin të zbatojë vendimet. Nuk mbrohet debitori duke i thënë mos paguaj kredinë!"-tha Manjani

ORARET

Ministri renditi gjithashtu çështjet më kryesore në Gjykata që kanë nevojë për përmisim. Së pari Manjani u kërkoi gjyqtarëve të respektojnë vendimet dhe oraret e



gjykimit pasi vonesat janë dhe vazhdojnë të mbeten të patolerueshme. "Dy inspektorët më mi, rastësisht u gjenden në një gjykatë javën që shkoi, në një bisedë me një gjyqtare, e cila zyrtarisht kur po zhvillonte bisedën, ishte anëtare e një trupi gjyqësor. Nuk më erdhi as ankesë zyrtare dhe as palët, por inspektorët. Nuk po i hyj fare edhe rasteve të Gjykatës së Apelit të Tiranës. Orari i gjykimit është ABC-ja e çdo takimi. Edhe kur i riu del për qejf, ka një orar, jo më gjykimi."-u shpreh Manjani



Ministri Manjani gjatë konferencës

para gjyqtarëve

PRONAT

Lidhur me çështjet e pronësisë ai tha se mesazhi që "prona nuk po shkon tek i zoti, por tek më i zoti, është një histori e vjetër. "Unë jam koshient që zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk është 100% aty ku duhet. Gjykatat tentojnë të anashkalojnë listën e ekspertëve të

licencuar nga shteti. Një person që ka mbaruar mjekësi nuk mund të jetë detyrimisht ekspert mjeko-ligjor në qoftë se nuk është licencuar nga shteti. Na ka ndodhur në një gjykatë që merren dy mjekë dhe hedhin poshtë të gjitha aktet e ekspertimit me firmë dhe me vull të njohur nga shteti dhe kjo ishte në dëm të një spitali privat. Do t'i bëjmë edhe inspektimet."

MINISTRI I BRENDSHËM

Tahiri takon homologun grek: Të bashkëpunojmë për refugjatët

Për Shqipërinë është i domosdoshëm një bashkëpunim akoma më i ngushtë me partnerët edhe fqinjët tanë



Saimir Tahiri gjatë vizitës në Greqi me homologun e tij grek Nikolaos Toskas

Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri gjatë vizitës në Greqi është takuar me homologun e tij grek Nikolaos Toskas ku ka kërkuar bashkëpunim dypalësh sa i takon çështjes së refugjatëve. Përveç kësaj, në qendër të takimit të dy zyrarëve të lartë ka qenë çështja e emigrantëve shqiptar që jetojnë në Greqi. "Biseda jonë prek një sërë çështjesh: që nga ato që kanë të bëjnë me qytetarët tanë që jetojnë në Greqi, deri ta ndaj çështja e sigurisë, lufta ndaj terrorizmit dhe kriza e refugjatëve," tha ministri Tahiri. Gjatë takimit që ministri i Brendshëm Saimir Tahiri zhvilloi me ministrin e Rendit Publik të Greqisë Nikolaos Toskas

është diskutuar edhe për krizën e emigrantëve sirian. Sipas ministrit Tahiri është shumë i rëndësishëm të kemi një plan të përbashkët për përballimin e kësaj krize. "Kemi kuptuar bashkërisht se nevojitet një bashkëpunimin në kuadër të Bashkimit Europian. Dhe për Shqipërinë është i domosdoshëm një bashkëpunim akoma më i ngushtë me partnerët edhe fqinjët tanë Greqinë dhe Italinë." thek-

soi ndër të tjera ministri Tahiri. Në këtë vizitë ministri i Brendshëm Saimir Tahiri shoqërohej edhe nga ZV/ministri i Brendshëm Stefan Çipa dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Haki Çako. Një ditë më parë ministri Tahiri zhvilloi edhe një takim në Athinë me shoqatat e emigrantëve ku u ndal në lidhje me procesin e regjistrimit të emigrantëve shqiptarë në vendet ku ndodhen.



MINISTRIA E BUDZHETIT DHE ADMINISTRIMIT TË LËNJAVE



Agjencia e Pagesave






Skemat e mbështetjes në bujqësi 2016

Ministria e Bujqësisë dhe Agjencia e Pagesave vazhdojnë edhe këtë vit nxitjen e zhvillimit të bujqësisë!

Afati aplikimeve: 15 Mars - 13 Prill 2016

Për informacione të mëtejshme AZHBR:
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr. 56, Tiranë.
Tel: +355 422283 18, Website: www.azhbr.gov.al
ose pranë Drejtorive të Bujqësisë në Qarqe

Përse duhet të kursejmë në fondet private vullnetare të pensionit



ESTELA KOÇI*


Pensionit është e ardhura kryesore gjatë periudhës kur individët nuk janë më të aftë për punë. Për shkak se individët humbasin mundësinë e sigurimit të një të ardhure në atë moshë, për përfitim të këtij pensioni, individët shpërblehen nga shteti nëpërmjet sigurimeve shoqërore, si dhe përdorin kursime të tyre, të bëra gjatë kohës së punës. Shuma e pensionit duhet të jetë në atë masë, që të ruajë të njëjtin cilësi jete, që individit ka patur gjatë viteve të punës. Individët nuk duan një rënie drastike të cilësisë së tyre të jetës gjatë pensionit. Raporti i zëvendësimit që pjesëton shumën e pensionit me mesataren e pagës përgjatë viteve të punës, krahason pikërisht cilësinë e jetesës në këto dy stade të jetës. Për shkak të ndryshimit të stilit të jetesës, taksave dhe kursimit, ky raport sugjehet nga ekonomistët që të jetë në masën 75%, pra individëve u duhet si pension rreth 75% e vlerës së pagës mesatare të fituar gjatë viteve të punës. Vetëm në këtë mënyrë ruhet cilësia e jetës edhe gjatë pensionit.

Në Shqipëri, shteti aktualisht siguron një pension me një raport zëvendësimit rreth 30-40%. Për rrjedhojë, që individët të ruajnë të njëjtin cilësi jete, ata duhet të kursejnë vetë gjatë viteve të punës që të arrijnë një raport zëvendësimit prej 75%. Në Shqipëri, si dhe në çdo vend në Ballkan apo vende anëtare të Bashkimit Europian, ekzistojnë skema private për zgjidhjen e problemit të pensionit. Ato realizohen nëpërmjet Fondëve Private Vullnetare të Pensionit, të cilat aktualisht investojnë kursimet e individëve në bono dhe obligacione të Republikës së Shqipërisë.

AVANTAZHET

Fondet e Pensionit Vullnetar ofrojnë në kuadrin e një legjislacioni me të njëjtat standarde të vendeve të Bashkimit Europian dhe monitorohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Ndër këto standarde ndërkombëtare, për të incentivuar rritjen e kursimit dhe për ta bërë këtë investim më të leverdishëm se çdo investim tjetër, ligji i posaçëm Nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" ka huazuar lehtësira fiskale dhe përfitim të tjera. Kontributet që derdhen në skema vullnetare private përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat; pra një individ që kontribuon në këto skema, paguan më pak tatim se sa një person

Si të ruash standardin dhe cilësinë e jetës pasi pushon së punuari



që nuk paguan kontribute pensioni me të njëjtën pagë bruto. Interesi dhe çdo e ardhur tjetër nga asetet ku investohet fondi i pensionit përjashtohen nga tatimi mbi fitimin. Individët mund ta tërheqin shumën e akumuluar në fondin e pensionit pesë vite para moshës ligjore të pensionit. Ekziston mundësia e kthimit të investimit të akumuluar në pagesa në formë pensioni, duke fituar sërish interes. Pagesat mujore për kontribute vullnetare në skemën profesionale bëhen automatikisht nga punëdhënësi sipas kontratës së antarësimit në fond.

Fondi i akumuluar është i trashëgueshëm dhe i transferueshëm. Ka garanci operacionale. Asetet, konkretisht, obligacionet dhe bonot e Republikës së Shqipërisë, regjistrohen në një regjistër elektronik, që ndodhet pranë Bankës Qendrore. Asetet e fondit ruhen nga Depozitari dhe mbikëqyrën nga AMF. Është përgjegjësia e Depozitarit të mos lejohet përdorimi i aseteve të fondit në kundërshtim me politikën e investimeve.

Individët mund të marrin pjesë në fondet e pensionit vullnetare nëpërmjet dy skemave: 1) Skema individuale - Në skemën individuale vetëm individit apo punë marrësi kontribuon në masën dhe periudhën e dëshiruar dhe 2) Skema profesionale - Punëdhënësi dhe punë marrësi derdhin kontribute në fond në përfitim të punë marrësve.

Sa më herët të fillojë kursimi për pension aq më i madh do jetë përfitimi nga interesi.

SHEMBULL

	Kursimi i Hershëm	Shtyrja e kursimeve
Metoda e kursimit për 30 vitet në vazhdim	Investo Lekë 12,000 çdo vit (1,000 Lekë/muaj) për 8 vitet e para. Asnjë investim për 22 vitet në vazhdim	Mos investo gjatë 8 viteve të para. Investo Lekë 12,000 në vit për 22 vitet në vazhdim
Shuma totale e kontributeve	12,000 X 8 vite=96,000	12,000 X 22 vite=264,000
Kontributet + Interesat e akumuluar nga investimi mbas 30 viteve	749,431	718,720
% e kursimit ndaj totalit të përfitimit	13%	37%

Ky shembull hipotetik supozon kontribute vjetore prej Lek 12,000 me një normë interesi prej 8% dhe nuk konsideron efektin e taksave.

Shëmbulli është vetëm për qëllime ilustrative dhe nuk pasqyron ndonjë investim aktual. Norma e kthimit mund të rezultojë me e vogël apo më e madhe se 8%.

ZHVILLIMET E TREGUT

Tregu i pensioneve private vullnetare në Shqipëri mbetet një treg i pazhvilluar në krahasim me tregun financiar në vend, si dhe në krahasim me vendet e Rajonit. Numri i individëve në skema pensioni vullnetare është shumë i vogël. Ai zë vetëm 3.3% të totalit të të punësuarve në sektorët e ekonomisë, përveç agrikulturës. Pavarësisht rritjeve të larta të zgjerimit, tregu mbetet i kufizuar, pothuajë i papërfillshëm në raport me Produktin e Brendshëm Bruto. Më poshtë është një pamje e zhvillimit të këtij tregu për numër antarësh të tre fondeve që operojnë në treg, që nga licensimi sipas kërkesave të ligjit të ri.

Me Vendimin nr.173, datë 13.12.2011 të Bordit të AMF u miratua Fondi i Pensionit Vullnetar "SiCRED Pensions" i administruar nga Shoqëria Administruuese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a me aksioner kryesor Credins Bank. Fondi i Pensionit Vullnetar "SiCRED Pensions" është një ndër tre fondet që operojnë sot në tregun e pensioneve vullnetare. Misioni i SiCRED Pensions është ruajtja e cilësisë së jetesës edhe gjatë fazës së pensionit. Në përputhje me këtë mision, Shoqëria Administruuese është pranë klientit gjatë të gjithë kohës së gjatë që karakterizon planifikimin për pension, duke e kështilluar

ngushtë me atë çfarë njerëzit në të vërtetë kërkojnë. Përveç menaxhimit të aseteve të fondit, Shoqëria Administruuese e Fondit të Pensionit u ofron antarëve këshillim financiar, edukim dhe manaxhim risku.

Falë bashkëpunimit intensiv me Credins Bank, është mundësuar promovimi i fondit të pensionit, në të gjithë Shqipërinë duke siguruar një njohje më të mirë të produktit me një përjasje të thjeshtë. Kombinimi i produkteve bankare me produkte afatgjatë si fondi i pensionit është një avantazh i shtuar në dobi të klientëve. Në fund të vitit 2015 SiCRED Pensions kishte 4,490 antarë me një total asetesh prej Lekë 135,974,221. Fondi ka patur rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2015 krahasuar me një vit më parë, duke u rritur si fondi i dytë në treg për sa i përket numrit të antarëve. Sipas një studimi të Bankës Botërore, rritja e numrit të antarëve të Fondit "SiCRED Pensions" ka patur peshën më të madhe në rritjen e numrit të antarësuarve në fondet e pensionit vullnetar gjatë vitit .

DOMOSDOSHËRIA E KOLONËS SË DYTË

Sistemi i plotë pensional përbëhet nga tri kolona e parë është e publikë (pay-as-you-go) e ofruar nga shteti, kolona e dytë është e detyrues private dhe kolona e tretë është vullnetare private. Për shkak se individët të lënë të lirë nuk kursejnë për pension, shumë shtete e kanë bërë këtë kursim të detyrueshëm, duke bërë efektive kolonën e dytë të sistemit



dhe Maqedonia. Në Europën Juglindore të gjitha vendet e kanë aplikuar kolonën e dytë përveç Republikës Çeke. Implementimi i kolonës së dytë në Shqipëri përbën domosdoshmëri për shkak se pjesëmarrja në kolonën e tretë është shumë e ulët dhe nuk pritet që ajo të zgjerohet konsiderueshëm aq sa t'i sigurojë të gjithë popullsisë një të ardhur shtesë. Shteti duhet medomos të fillojë përgatitjen e kushteve për ndërtimin e kolonës së dytë. Shqipëria mund të shfrytëzojë më së miri eksperiencën e vendeve të tjera për implementimin e kësaj reforme të rëndësishme, duke qenë në një pozicion të favorshëm për të mos përsëritur të njëjtat gabime të reformave të ndërmarrja në botë.

ÇFARË PRITET NË 2016

Shoqëritë Administruuese të Fondëve të Pensioneve janë të përfshira në një projekt që AMF po zbaton me mbështetjen e Bankës Botërore në funksion të nxitjes së zhvillimit të tregut të fondeve të pensioneve vullnetare private dhe përmirësimit të mbikëqyrjes së këtij tregu. Projekti "Mbikëqyrja e pensioneve dhe zgjerimi i mbulimit" ka filluar në Korrik të vitit 2014 dhe pritet të përfundojë në tremujorin e parë të vitit 2016. Ai ka dy komponentë kryesorë, të cilët janë: mbikëqyrja e tregut të pensioneve dhe zgjerimi i këtij tregu. Në janar të 2014-s me ndihmën e ekspertëve të Bankës Botërore filloi puna për ndryshimet në Ligjin nr.10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar Amendimet e propozuara synojnë përmirësimin dhe rregullimin e mëtejshëm të ligjit për ta përshatuar me zhvillimet e fundit në fushën e pensioneve vullnetare dhe me direktivat e BE-së.

Një nga ndryshimet pozitive të ligjit, që pritet të miratohet brenda vitit 2016, është zgjerimi i mëtejshëm i lehtësive fiskale duke bërë që të taksohet vetëm përfitim nga e ardhura nga investimi në momentin që individit plotëson kushtet për të përfutur pensionin vullnetar.

Si rrjedhojë e përfshirjes më të madhe të autoritetit rregullator dhe organizave ndërkombëtare, pritet të rritet ndërgjegjësimi i kompanive punëdhënëse për të krijuar skema profesionale pensioni për punë marrësit e tyre.

* Administratore e Përgjithshme SiCRED Pensions sh.a

Formulë e re për ndihmën ekonomike të 40 mijë familjeve

Projektligji në Kuvend: Ndhimja ekonomike të jepet vetëm e plotë, përfitojnë familjet bujqësore

ESIONA KONOMI
TIRANE

40 mijë familje që aktualisht trajtohen me ndihmë ekonomike të pjesshme nuk do ta marrin më atë. Sipas një projektligji më të fundit të hartuar nga qeveria për mbrojtjen shoqërore, familjet në nevojë që do të plotësojnë kriteret, do të përfitojnë vetëm ndihmë ekonomike të plotë. Nëse Kuvendi do ta miratojë, ky projektligji i fillon efektet në 1

Familjet

"Aktualisht, trajtohen me ndihmë ekonomike të pjesshme në 9 qarqe të vendit 40339 familje, të cilat me skemën e re do të kenë mundësinë të aplikojnë dhe përfitojnë ndihmë ekonomike në masë të plotë sipas strukturës së familjes"

shtator 2016. Me ndryshimet që qeveria propozon të miratohen përmes Kuvendit, saktësisht në nenin 19 të ligjit parashikohet që ndihma ekonomike të jetë vetëm në masë të plotë dhe jo më në masë të pjesshme, ku nga

përlogaritja e të ardhurave të familjes bujqësore nuk mund të përfitonin ndihmë ekonomike të pjesshme familjet, të cilat, pas llogaritjeve me koeficient të të ardhurave marrin deri në 800 (tetëqind) lekë në muaj. "Aktualisht, trajto-

hen me ndihmë ekonomike të pjesshme në 9 qarqe të vendit 40339 familje, të cilat me skemën e re do të kenë mundësinë të aplikojnë dhe përfitojnë ndihmë ekonomike në masë të plotë sipas strukturës së familjes"-thuhet në

relacionin e projektligjit të qeverisë. Një tjetër ndryshim i propozuar, është mosdhënia e ndihmës ekonomike përgjithmonë. Në nenin 10 të ligjit parashikohet që ndihma ekonomike të kufizohet në kohë dhe ky rregullim do të bëhet me akte nënligjore. "Ky kufizim kohor do të synojë integrimin në jetën shoqërore të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike dhe për ta kthyer këtë në një skemë aktive"-thuhet në relacion. Masat përjashtuese nga skema e ndihmës ekonomike për ato familje të cilat nuk zbatojnë kërkesat e legjislativit në fuqi do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe do të parashikojnë kryesisht raste të tilla si deklarime të rreme, mashtrim, refuzimin e ofertave të përshatshme të punës etj. Projektligji, gjithashtu, parashikon edhe përditësimin e formulës së unifikuar të pikëzimit nga autoriteti shtetëror përgjegjës për ndihmën dhe shërbimet shoqërore në vartësi të nivelit të varfërisë në vend. Është hequr nocioni i kushtëzimit të ndihmës ekonomike me punë e shërbime. Në nenin 20 të ligjit parashikohet që ndihma ekonomike shpërndahet me vendim të strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe pagesat e aftësisë së kufizuar me vendim të këshillit bashkiak. Është parashikuar afati dhe mënyra e njoftimit të përfuttesve të skemës së ndihmës ekonomike e cila do të realizohet nga pushteti vendor brenda 24 orëve nga njoftimi i vendimit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror duke publikuar atë (afishuar në ambientet e bashkisë/njësisë administrative).

ANKIMIMI/ PROCESET NE GJYKATEN ADMINISTRATIVE

Ja si mund të veproni kur ju mohohet ndihma ekonomike

Me nismën e re të qeverisë, parashikohet shfuqizimi i procedurës së ankimit në gjykatë për subjektet përfuttes, duke krijuar mundësinë fillimisht të ankimit administrativ dhe më tej të ankimit në gjykatën administrative. Aplikuesi për përfitim të ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund të paraqesë ankesë, me shkrim, pranë bashkisë/njësisë administrative, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton, me shkrim, ankuesin, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës. Aplikuesi për përfitim të ndihmës ekonomike ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit të parë.

KERKESA
Aplikuesi ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit të parë



QEVERIA

Ndihmë ekonomike edhe për azilantët e mitur

Qeveria i ka propozuar Kuvendit që në kategorinë e përfuttesve të shtohen dhe azilantët e mitur. Neni 6 riformulohet në këtë mënyrë, duke bërë këtë ndryshim lidhur me azilantët. "Përfuttesit e shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë, deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë, vajzat në nevojë, azilantët e mitur, të pasqoruar, për efekt të përfutimit të shërbimit të kujdestarisë, sipas përcaktimeve të nenit 15, të këtij ligji, si dhe të gjithë ata që janë në rrezik të bëjnë pjesë në grupet në nevojë"-thuhet në nenin 6 sipas projektligjit.



AFATI

Nëse Kuvendi do ta miratojë, ky projektligji i qeverisë për mbrojtjen shoqërore i fillon efektet në 1 shtator 2016, pas rishikimit të buxhetit

SKEMA

Sipas projektligjit për mbrojtjen shoqërore, familjet në nevojë që do të plotësojnë kriteret, do të përfitojnë vetëm ndihmë ekonomike të plotë

Faksimile e projektligjit të qeverisë për mbrojtjen shoqërore

Bashkitë Dyfishohen fondet për ndihma ekonomike

Në kuadër të decentralizimit, bashkitë do të kenë mundësi të japin ndihma ekonomike për familjet në nevojë dyfish më shumë se deri tani. Projektligji i sjellë nga qeveria, në nenin 21, parashikon të dyfishohet fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike nga 3% në 6% të cilit këshilli i bashkisë ka të drejtë ta përdorë duke shtuar ose jo fonde nga buxheti vendor për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur përfuttes nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. "Qëllimi i dyfishimit të këtij fondi është për ti ofruar pushtetit vendor mbështetje financiare më të madhe dhe më shumë kompetenca për të mbështetur familjet në nevojë me vendim-marrjen e tyre. Në nenin 29, të ligjit (neni 11 i aktit ndryshues) parashikohet që këshilli i bashkisë merr vendimin për propozim për familjet/individët në nevojë që duhet të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën e përfutimit për këto familje/individë në nevojë. Ky vendim për propozim i përcillet menjëherë zyrtarisht strukturës rajonale të shërbimit social shtetëror e cila merr vendimin përfundimtar.

“Admiri kreu vrasje të trefishtë, la dy fëmijët e tij jetimë”

Gjykata mbyll në qeli gardistin Dervishi njoftoi policinë pas kryerjes së vrasjes


Nëna e dy fëmijëve të ekzekutuar nga bashkëshorti i saj gardist nuk do të mbajë më mbiemrin e të shoqit Dervishi, por atë të vajzërisë Spahia. Është ky vendimi i familjes së Idës, e cila banon në lagjen e njohur si Parku i Autobuzëve në kryeqytet, në katin e parë të këtij pallati parafabrikat. Pamjet flasin vetë për kushtet ekonomike të familjes Spahia, ku siç na thotë Ferideja jashtë kamerave, fëmijët e Idës do të rriten jetim, siç u rrit Ida pa babain dhe nëse drejtësia nuk dëmon vrasësin e vajzës së saj, atëherë ajo do hakmerret. Daja i Idës vrasjen e cilëson një krim të trefishtë, pasi me vdekjen e Idës fëmijët mbeten në rrugë: “Është një vrasje e trefishtë, sepse ka lenë dy fëmijë të vegjel jetim. “Mbesa ime vdiq nga një vendim i padrejtë i tij. Maskara nuk mund t’i thuash, sepse është emër i bukur”.

PËRGJEGJËSIA MBI SHETIN

Admir Dervishi i morri jetën Idës, ndërsa familjarët e së ndërjes shprehën se përgjegjësia bie mbi autoritet shtetërore. Shkak është mosrespektimi i një urdhër mbrojtjeje, sipas së cilit, Admir Dervishi duhej t’i qëndronte larg, ta respektonte dhe mos ta dhunonte bashkëshortin e tij, por ai i morri jetën e armën e shërbimit. “I bëj thirrje organeve të shtetit, hetuesisë, që në qoftëse deri dije nuk e kanë mbrojtur këtë vajzë, sot të nxjerrin në



Gardisti Admir Dervishi



Ilda Dervishi (Spahia)

pah të vërtetën, realitetin, për hatër të fëmijëve dhe për të gjithë ne”-shprehet daja i viktimit. Ai ka treguar me tej se nëpërmjet lajmeve, s’dinim gjë, shërrët ishin të përditshme, dhuna e tij ka qenë e pandërprerë. Edhe pse ka shumë vendime nga gjykata, ai ka vazhduar jetën e tij makabre karshi kësaj

femre. Ndërkohë, Admir Dervishi autori krimi këtë të premtë u la në burg nga Gjykata e Krimeve të Rënda me akuzën e vrasjes për shkak të mardhënieve familjare. Seanca ndaj tij u zhvillua me dyer të mbyllura ku mësohet se efektivi i gardës është shprehur se s’kish qëllim të vriste gruan, por ta trembte atë me armë.

➔ PËRGJEGJËSIT

Dervishi i morri jetën Idës, ndërsa familjarët e së ndërjes shprehën se përgjegjësia bie mbi autoritet shtetërore. Shkak është mosrespektimi i një urdhër mbrojtjeje, sipas së cilit, Admir Dervishi duhej t’i qëndronte larg

➔ DAJA I VIKTIMES

“I bëj thirrje organeve të shtetit, hetuesisë, që në qoftëse deri dije nuk e kanë mbrojtur këtë vajzë, sot të nxjerrin në pah të vërtetën, realitetin, për hatër të fëmijëve dhe për të gjithë ne”-shprehet daja i viktimit

GARDISTI NJOFTOI VETË POLICINË

Prokuroria për Krime të Rënda kërkoi caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, e cila u pranua nga



Arjan Maçaku daja i Ida Spahia

gjykata, për shtetasin Admir Dervishi, i dyshuar për veprën penale të “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare” në ngjarjen ku mbeti e vdekur me armë zjarri bashkëshortja e tij. Nga aktet e referuara në Prokurorinë për Krime të Rënda rezultoi se në mëngjesin e datës 6 prill 2016, Admir Dervishi, efektivi i Gardës së Republikës, pas një konflikti të mëparshëm që ka patur me bashkëshortin e tij, I.S., gjatë kohës që kanë qenë në ambientet e banesës së tyre (të marrë me qera) në “Rrugën e Qelqit”, në Kombin, Tiranë, ka nxjerrë pistoletën e shërbimit që mbante me vete dhe ka qëlluar disa herë në drejtim të bashkëshortes së tij, duke i shkakuar asaj vdekjen e menjëhershme. Pas kësaj, shtetasi Admir Der-

vishi, ka njoftuar organet e policisë dhe ka pritur në vendin e ngjarjes deri në momentin e mbërritjes së tyre. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes u sekuestruan në cilësinë provës material një armë pistoletë kalibri 7.62 mm, tre fishekë kalibri 7.62 mm, dy predha, katër gezhoja model 54, kalibri 7.62 mm, një këmbish predhe. Në lidhje me këtë ngjarje është pyetur i arrestuari Admir Dervishi, i cili ka pranuar autorësinë e kryerjes së veprës penale, duke treguar në mënyrë të detajuar edhe kronologjinë, por edhe motivet që e kanë shtyrë në kryerjen e kësaj veprë penale. Në këto kushte, nga ana e policisë gjyqësore është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit Admir Dervishi, për veprën penale të “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare”.

LAJME SHKURT



Tom Lala

Kurbin, gjykata lë në burg Tom Lalën, vrau 50-vjeçarin Mark Ndreca

“Arrest në burg” ka qenë masa e dhënë nga Gjykata e Kurbin për 69-vjeçarin Tom Lala autor i vrasjes së 50-vjeçarit Mark Ndreca, ngjarje e ndodhur të shtunën e kaluar në fshatin Gallat. Nën masa të rrepta sigurie ai u paraqiti në gjykatë për tu njohur me masën e sigurisë, ndërsa të pranishëm ishin dhe familjarët e tij. Në seancën e cila është zhvilluar me dyer të mbyllura mësohet se 69-vjeçari Lala e ka pranuar krimin e kryer prej tij, ndërsa ka shfaqur pendesë për atë çfarë ka ndodhur. Në dëshminë e tij para togave të zeza Lala ka deklaruar se, ka qëlluar për vetëmbrojtje, pasi viktima në momentin e konfliktit ka zbritur nga makina. “Në momentin kur unë e parakalova dhe ndalova për tu sqaruar me të, Mark Ndreca doli nga makina dhe futi duart në brez. Në atë moment unë mendova se ai kishte armë dhe po e nxirrte që të më qëllonte mua

Qëlloi shokun me pistoletë stilolaps prangoset 17-vjeçari

Një konflikt i çastit mes dy adoleshentëve në Fier ka degjeneruar në përdorimin e armës tip pistoletë stilolaps, ngjarje në të cilën ka mbetur i plagosur njëri nga të rinjtë. Sipas të dhënave nga policia e Fierit, bëhet e ditur se, në shkollën e Muzikës “Jakov Xoxa” G.D.17 vjeç ka plagosur rëndë nga pakujdestia shokun e tij P.Sh, banues në lagjen “Liri”, menjëherë pas ngjarjes është dërguar për mjekim më të specializuar në Tiranë. Pas ngjarjes, në vendin ku ndodhi plagosja ka shkuar edhe grupi hetimor i cili ka bërë të mundur sekuestrimin e një arme zjarri pistoletë (tip stilolaps), në dukje artizanale, me të cilën dyshohet se 17-vjeçari ka kryer plagosjen.



Tryeza me delegacionin e zviceris

Zv/drejtori takim me drejtuesit e policisë franceze

Zv/Drejtori i Policisë së Shtetit, Rebaui Jaupi, priti në një takim një delegacion të Zyrës Federale të Policisë së Zviceris, i kryesuar nga zj. Nikola Della Valle, Drejtorëshë e Zyrës Federale të Policisë së Zviceris. Drejtuesit e lartë policorë të të dy vendeve evidentuan nivelin shumë të mirë të bashkëpunimit ndërmjet Policisë Shqiptare dhe Policisë Zviceriane në luftën kundër krimi të organizuar, narkotikëve e trafikëve, kjo në kuadër edhe të marrëveshjes ekzistuese në fushën e bashkëpunimit policor mes dy vendeve. Njëherazi u evidentuan edhe çështje në interes dypalësh, ku ky bashkëpunim dhe shkëmbimi i informacionit do të intensifikohen edhe më tej, si në fushën e falsifikimit të parave, krimi kibernetik dhe terrorizmit.

Kurbin

Aksidentohen dy makina të eskortës së Ditmir Bushatit

Dy automjetet e eskortës së shoqërimit të ministrit të Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati janë përplasur me njëri-tjetrin. Këto janë të dhënat e fundit nga aksidenti mbrëmjen e të premtës në Rrugën e Kombit. Sipas njoftimit të Policisë së Shtetit, në orën 18:30 në aksin rrugor Thirrë - Rrëshen - Milot në vendin e quajtur Ura Fanit, në dalje të Autostradës Kalimash-Rrëshen, ka ndodhur një aksident automobilistik me pasojë vetëm dëme materiale (karambol) ndërmjet dy mjeteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Po sipas Policisë, makina ku udhëtonte ministri Bushati është goditur nga pas nga makina e tretë e shoqërimit. Nga aksidenti nuk ka të lënduar, por vetëm dëme materiale. “Në vendngjarje u kryen të gjitha veprimet administrative nga Seksioni i Policisë Rrugore i Komisarariatit të Policisë Mirditë për t’u trajtuar nga kompanitë e sigurimit për dëmin e shkakuar”, thuhet në njoftimin e Policisë. Ministri Ditmir Bushati, njëherazi koordinatori i PS për veriun, po kthehej pas një takimi me anëtarësinë e PS në Kukës.



J KANCER Eduko, parandal!

vijon nga numri i djeshëm

E NEIDA XHELILI
TIRANE

Miqte e mi, përshëndetje! Jemi së bashku në një ambient shumë simpatik, ku shpeshherë kemi folur, kemi biseduar për përvoja të rëndësishme. Këtu i referohem edhe ndërgjegjesimit që neve duam, gjithmonë, t'i përcjellim popullatën, juve, por edhe vetes sonë ia themi shpeshherë. Këtu i referohem sëmundjeve kanceroze. Jo pak emisione kemi bërë së bashku për kancerin e gjirit, por edhe për lloje të tjera tumoresh. Duke qenë se ne e kemi nisur këtë emision, duam ta vazhdojmë. Por jo gjithmonë mund t'i referohemi vetëm mjekësisë. Një mesazh shumë i mirë janë edhe përvojat e drejtpërdrejta të personave, të cilët kanë ditur të ndjekin rrugën e duhur për të ruajtur shëndetin e tyre, për t'u diagnostikuar në kohë, në faza të hershme. Kjo falë kontrolleve të rëndësishme që kanë bërë atëherë kur duhet. Nuk po zgjatem më tepër. Dua që të përshëndes zonjën Majlinda Nanaj, e cila sot pranoi që të flasë dhe të rrefejë përvojën e saj për të gjithë ju, edhe për ne.

Si ka qenë marrëdhënia me mjekët gjatë të gjithë kësaj periudhe jo të shkurtër?

Për të qenë singertë, unë të gjitha ndërhyrjet kirurgjikale i kam bërë në Athinë. Nuk kam bërë absolutisht asgjë këtu, prandaj nuk mund të flas për doktorët që janë këtu. Për sa i përket mjekëve atje, ata kanë një lloj tjetër trajtimi të pacientit, kanë njerzillëk, kanë embëlisi në të folur. Mënyra sesi ata të presin të bën që të ndihesh jo i sëmurë.

Si duhet të jetë ky komunikim në parim? Ç'rëndësi ka se nga është mjeku, është shqiptar apo italian, grek, amerikan.

E thamë edhe një herë që në këto lloje sëmundjesh komunikimi me mjekun, me psikologun dhe me familjen duhet të jetë parësori. Mjeku në radhë të parë duhet të jetë njeri dhe këtë lutje e bëj për të gjithë mjekët kudo që janë. Duhet të jenë njerëz. Jua thashë, kam kaluar eksperiencën shumë të shëmtuara me sëmundjen e nënës sime, këtu në Shqipëri. Duhet të jenë njerëz. Atë që duhet të japë, duhet ta japë nga shpirti, nëse i lind dëshira ose nëse është detyrim për t'u paguar. Por, iu lutem, të mos humbin njerzillëkun. Kjo sëmundje do shumë dashuri.

Për çfarë mendoni se vlen e gjithë kjo përvojë e juaja, kur e shikoni në mënyrë të qetë në këtë periudhë koha tani, pasi e keni kaluar këtë kalvar të gjatë.

Për mua, mund të them që është një thirrje për të gjithë, për gratë, për vajzat. Të mundohen, të kujdesen sa më shumë për jetën e tyre, të mos neglizhojnë asnjë hap. Është një thirrje për bashkëshortët e këtyre grave, që t'u qëndrojnë afër. E thamë edhe një herë, që nuk qëndron bukuria as te flokët as te buzëkuq, por qëndron te shpirti. Këto gra, këto nëna kanë nevojë për shumë, shumë dashuri në këto momente. Është një fazë kalimtare. Kalon edhe faza e kimioterapisë edhe faza e rrezëve. Me kalimin e kohës, të tëra harrohen. Kur gjërat shkojnë mirë, çdo gjë harrohet.

Dua që ndalem edhe në një aspekt tjetër. Ju gjithandej po përmendi fjalën e të qenit njeri dhe aspektin intelektual. Sa mendoni ju se vuan shoqëria shqiptare nga këto problematika? Sepse që në momentin që një grua ka të bëjë me zhveshjen, të dalët përpara një mjeku, vendosjes përpara një aparature. Besoj se kemi ende tabu të tilla.

Absolutisht që po. Fakti i përhapjes së kësaj sëmundjeje në një shkallë shumë të madhe dhe mosdiagnostikimi në fazat e hershme, tregon që ne kemi probleme të kësaj natyre. Dua t'ju jap shembullin tim konkret. Në momentin që unë diagnostikohem dhe bëj mamografinë, më orientojnë për të bërë një eko gjiri. Bashkëshorti im ka qenë prezent.



NË FOTO: Majlinda Nanaj, e cila përjetoi eksperiencën e sëmundjes dhe u shërua

Ja si arrita të dal fituese në luftën me kancerin e gjirit

Ish-pacientja rrëfen përvojën, jep mesazhin si të sfidohet sëmundja



Mjekët Mjeku në radhë të parë duhet të jetë njeri dhe këtë lutje e bëj për të gjithë mjekët kudo që janë. Duhet të jenë njerëz. Kam kaluar eksperiencën shumë të shëmtuara me sëmundjen e nënës sime, këtu në Shqipëri.

Dhe po jua them që nuk ka asgjë të keqe, nuk është absolutisht turp të zhvishesh dhe të kontrollosh jetën tënde. Në qoftë se do që të jesh me fëmijët e tu, me njerëzit e tu, nuk është turp. Nuk janë turpe këto. Duhet të ndërgjegjësohen të tërë. Kontrolli për veten duhet të jetë primari. Kot s'e ka thënë populli që po s'deshe veten, s'të duan të tjerët.

Një herë në sa kohë i bënit kontrollet tuaja periodike?

Unë jam akoma në fazë të hershme, kështu që i vazhdoj një herë në tre muaj.

Jo, po flas përpara se të mësonit se çfarë kishtë. Një herë në vit. Një herë në vit bëja Papestin dhe mamografinë, gjë të cilën vazhdoj ta bëj rregullisht edhe tani.

Kjo gjë do të vazhdojë?

Po. Patjetër, derisa të kem jetë. Dhe këtë po përpiqem që t'ia kultivoj edhe vajzës sime. Kam vajzën 15 vjeçe. Jam konsultuar me doktorët se në çfarë moshe duhet që Ana të fillojë të kontrollohet. Tani relativisht bëhet që në moshë të re. Nuk ka më që gratë duhet të fillojnë në moshën 40-45-vjeçare që bëjnë mamografi. Është ulur mosha e kontrollit si pasojë e përhapjes së sëmundjes nga shumë faktorë të ndryshëm si, natyra, ushqimi, stresi. Janë shumë faktorë që ndikojnë në shfaqjen e kancerit. Pra, jam konsultuar me doktorët dhe kontrollet duhet të fillojnë në moshë shumë të hershme, 20-25-vjeçare, të paktën me ekon e gjirit.

A mendoni se bëhet mjaftueshëm për ndërgjegjësimin e popullatës në lidhje me këtë fenomen?

Jo. Dhe kam një kërkesë, që ky ndërgjegjësim të mos ndodhë vetëm në muajin tetor, që është



Fizioterapia Gratë me kancer gjiri, në qoftë se nuk bën ushtrime të krahut, në krah duke mos qenë gjendrat limfatike, mblihdhe të gjitha lëngjet e trupit dhe krijohet një ënjtje e cila të sjell vështirësi në lëvizjen e krahut dhe të dorës

muaji i sensibilizimit për kancerin e gjirit. Të paktën media e di që bën një luftë shumë të madhe dhe arrin të bindë dhe të sensibilizojë shumë. Një ditë në muaj, le të ishte kjo kërkesë. Një ditë në muaj dhe besoj që arrihet.

Çfarë keni për të thënë tjetër nga ato gjëra që ju ndoshta i keni peng dhe do të donit që dikush tjetër t'i kapte më herët, t'i paraprinte këtyre problematikave, në lidhje gjithmonë me këtë lloj sëmundjeje.

Ne jemi mësuar që në këtë muaj të bëjmë thirrje dhe të sensibilizojmë gratë dhe vajzat për kontrollet e tyre. Por duhet të bëjmë edhe një thirrje për institucionet përkatëse, ku shkojnë këto gra dhe vajza për t'u përballur dhe për t'u shëruar nga kjo sëmundje. Në lidhje me ilaçet, në lidhje me trajtimin njerëzor që duhet t'u bëhet, në lidhje me dashurinë që duhet t'u japin, me përkushtimin që duhet t'u japin. I gjithë stafi nëpër spitale. Thirrje për të dyja palët, jo vetëm për gratë dhe për vajzat.

Zonja Majlinda, në fazat problematike, aq më tepër kur një person i diagnostikuar me kancer gjiri është nën trajtim, mund të bëjë një jetë normale? Çfarë ka në dorë që të bëjë në jetën e vet për ta normalizuar, përveç kurave të cilat nuk janë shumë të lehta.

Dy nga faktorët bazë që ndikojnë në përmirësimin e gjendjes si emocionale ashtu edhe shëndetësore të këtyre pacientëve, janë pikëspëpari, mënyra e të ushqyerit dhe aktiviteti fizik. Unë flas gjithmonë nga eksperiencia ime personale. Në asnjë moment nuk kam ndaluar së dal nga Liqeni Artificial sepse ne në Tiranë vetëm atë kemi. Sikur edhe me hapa të ngadalta të lëvizësh, duhet ta bësh sepe kjo sëmundje do oksigjen, do forcë. Sot do të bësh 10 hapa, nesër do të marrësh fuqi që të bësh 15, pasnesër 5 më tepër dhe kështu arrin t'i fitosh fuqitë, sepe vetë kimioterapitë dhe rrezet të lodhin. Por duhet shumë vullnet brenda vetes, që të arrihet kjo. Unë edhe sot e kësaj dite ecjen te Liqeni nuk e kam ndaluar asnjë ditë. Kanë kaluar dy vjet e gjysmë nga sëmundja dhe jam, mund të them, nga atletet e përditshme të Parkut Kombëtar.

E keni pasur nevojën e mjekut fizioterapist për riaftësimin ndoshta të pjesës së krahut?

Absolutisht po. Është e domosdoshme dhe jam përpjekur që ushtrimet që mua më kanë dhënë, sepe unë nuk mund të rrija gjatë të gjithë kohës në Athinë për të bërë fizioterapinë, dhe m'i jepnin edhe të fotokopjuara, t'i transmetoj edhe te mikeshat e mia që kanë pësuar të njëjtën gjë, pas meje. Dhe jam ndjerë me krahur kur i kam dëgjuar të më thonë që më kanë pasur shembull. Sepse fizioterapia ndikon jashtë mase. Te ne, te gratë me kancer gjiri, në qoftë se nuk bën ushtrime të krahut, në krah duke mos qenë gjendrat limfatike, mblihdhe të gjitha lëngjet e trupit dhe krijohet një ënjtje e cila të sjell vështirësi në lëvizjen e krahut dhe të dorës. Në sajë të këtyre ushtrimeve, unë sot nuk kam absolutisht as vështirësinë më të vogël.

Pra shohim që gama e hallkave është shtuar, le të themi. Në qoftë se deri dje kishim të bënim ndoshta vetëm me kirurgun, me kimioterapeftin, radioterapeftin, sot është zgjeruar gama duke filluar nga psikologu e me radhë.

Po. Hyn psikologu, hyn fizioterapefti, hyjnë dietat ushqimore, mënyra e të ushqyerit, por për mua, vendimtar është aktiviteti fizik. Unë nuk kam ndaluar as për një çast të mbyllem brenda edhe pse isha pa flokë, edhe pse isha pa vetulla. S'është asgjë. Unë isha unë dhe mua njerëzit më donin se isha unë.

E keni ndjerë vërtet se çfarë dashurie ju rrethonte, me atë që kaluat?

Kam ndjerë vërtet miqëti e mirë. Kam ndjerë dashuri pa fund. E ndjeja në shikimet që më jepnin, e ndjeja në përkëdheljet që më jepnin. Jam e privilegjuar që kam kaq njerëz që më duan dhe më duan sinqerisht. Dhe për mua kjo është pasuria më e madhe. E privilegjuar që kam një bashkëshort që më ka ndenjur në krah në çdo minutë timen, në çdo minutë të vuajtjes sime. Dhe në momentet që mund të dëshpërohesha moralisht, më inkurajonte. Ka qenë forca më e madhe që sot unë jam këtu ku jam.

Nuk pushojnë skandalet e firmave "off shore"


Probleme të shumta për David Cameron, Poroshenkon e Ukrainës, dyshime për rolin e Putinit

Skandal i "Panama Papers" vazhdon të krijojë turbullira në mbarë botën. Një analizë e "the Guardian" e cila tregon se çfarë balancash ka prishur publikimi i 11 milionë dokumenteve, rendit në vend të parë përfshirjen e Presidentit Vladimir Putin në aferën e marrëveshjeve të fshehta. Edhe pse emri i tij nuk rezultoi gjëkund, dyshohet se shefi i Kremilit nëpërmjet bashkëpunëtorëve ka kryer marrëveshje financiare "offshore" dhe ka marrë kredi të mëdha me vlerë deri në 2 miliardë dollarë. Por, për qeverinë e Moskës këto janë akuzat për të krijuara enkas destabilitet duke i cilësuar si "Putinfobia".

Në vendin e dytë prestigjiozja britanike rendit dorëheqjen e kryeministrit të Islandës, Sigmundur David Gunnlaugsson. Postin e tij e mori ministri i Bujqësisë dhe Peshkimit, Sigurdur Ingi Johannsson, i cili do të drejtojë ekzekutivin e Islandës deri në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme këtë vjeshtë.

Përfshirjen e një tjetër lideri në skandalin më të madh financiar, Petro Poroshenko, "the Guardian" e rendit në vendin e tretë pasi ishte vetë ai i cili kur u zgjodh në maj të vitit 2014 si President i Ukrainës bëri premtimin se do të pastrojë radhët e korrupsionit të politikës në vend.

Po ashtu, skandalin i "Panama Papers" përfshirte atë që dihej botërisht, censurën e Kinës. Pas përfshirjes së elitës



së politikës kineze në "Panama Papers", qeveria kineze urdhëroi të gjitha mediat të mos publikojnë asnjë lajm që ka të bëjë me skandalin, ndërsa edhe faqet e internetit të disa mediave ndërkombëtare janë të bllokuara pjesërisht dhe kinezët nuk mund të lexojnë se çfarë shkruhet mbi

sekretet "offshore".

Partia Laburiste akuzoi David Cameron për hipokrizi dhe kërkoi dorëheqjen e tij pasi ai pranoi se kishte zotëruar dikur aksione në një kompani jashtë vendit të krijuar nga babai i tij. Të enjten, kryeministri britanik tha se i kishte shitur aksionet

para se të bëhej kryeministër dhe se kishte paguar taksat për shitjen prej 30 000 sterlinash. Ai, gjithashtu, tha se kompania "Blairmore Holdings" nuk ishte krijuar për të shmangur taksat.

Por, lideri i laburistëve, Tom Watson tha se kryeministri më herët kishte deklaruar


LONDËR

Partia Laburiste britanike akuzoi kryeministrit David Cameron për hipokrizi dhe kërkoi dorëheqjen e tij, pasi pranoi se kishte zotëruar dikur aksione në një kompani jashtë vendit, krijuar nga i jati

ar se njerëzit që investonin në skema të tilla ishin duke gabuar moralisht. Dokumentat e Panamasë tregojnë se Ian Cameron, babai i ndjerë i kryeministrit, ishte një prej pesë drejtuesve të kompanisë që merrte pjesë në takimet e bordit në Bahamas apo Zvicër. Mediat britanike shkruajnë se kompania "Blairmore Holdings" ishte një fond për investitorët që deri në vitin 2006 përdorte bono thesari që i paguhen mbajtësit për të mbrojtur identitetin e klientëve. Sipas laburistit Tom Watson, Cameron nuk mund të fajësohet për veprimet e babait të tij, por mund të fajësohet për hipokrizi.

CEREMONIA

Kosovë, merr detyrën si president Hashim Thaçi



Dje në orën 11:00 u bë inaugurimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi në sheshin Skënderbeu në Prishtinë. Ceremonia u zhvillua nën masa të repta sigurie. Në të ishin të pranishëm presidenti, kryeministria, ministrat e ambasadorë të vendeve mike të Kosovës, përfshi edhe delegacioni shqiptar ndër të cilët presidenti Nishani, kryeministri Rama dhe kreu i Parlamentit Meta. Hashim Thaçi u drejtua tribunasë teksa doli nga selia e Presidencës i shoqëruar nga paraardhësja e tij Atifete Jahjaga. Në mënyre simbolike ajo i dorëzoi Thaçit një Kushtetutën e vendit, për të cilën ai premtoi se do jetë rojtari i saj. Para fillimit të ceremonisë në shesh u hodh gaz lotsjellës. Në lidhje me ngjarjen Policia e Kosovës ka vënë në pranga shtatë persona si të dyshuar kryesorë. Të ndaluarit, sipas policisë, kanë patur çanta me vete ku dyshohet se ruanin gazin lotsjellës.

TERRORIZMI

Kerry: ISIS po falimenton, i ka ditët e numëruara



"ISIS i ka ditët e numëruara". Optimizmi është shprehur nga sekretari amerikan i Shtetit, John Kerry gjatë një vizite në Irak. "Në këtë vend, Shteti Islamik ka humbur 40 për qind të territorit që kishte pushtuar", ka deklaruar Kerry në një konferencë për shtyp, të transmetuar nga televizioni Al Jazira. Shefi i diplomacisë amerikane ka kujtuar se, që prej vitit të kaluar, trupat qeveritare irakene i rrëmbyen organizatës terroristike qytetet Tikrit, Sinjar, Ramadi dhe në ditët e fundit, Hitin, në provincën perëndimore të Al Anbarit. Gjithashtu, "të paktën 100 drejtues të lartë të Kalifatit janë eleminuar", ka shtuar Kerry.

BLLOKIMI / ZAGREBI: NUK KA STANDARDE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Kroacia vendos veton për bisedimet mes BE dhe Serbisë

Kroacia bllokoi bisedimet e anëtarësimit për Serbinë duke vendosur veton në hapjen e kapitullit 23 dhe 24 me Beogradin. Grupi i përbashkët i punës i ngritur në Këshilli i Europës shtyu agjendën e debatit mbi dy kapitujt e radhës me Serbinë, kapitujt që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut. Agjenda nuk është votuar vetëm nga pala kroate, ndërkohë që

rregulli në të tilla raste kërkon votë unanime nga 28 vendet anëtare të Bashkimit Europian. Zagrebi nuk ka shpjeguar ende me detaje arsyet e bllokimit të bisedimeve të anëtarësimit për Serbinë, por javët e fundit zyrtarë të lartë kroatë kanë deklaruar jo pak herë se do të bllokojnë procesin e anëtarësimit nëse Beogradi nuk plotëson më parë disa kushte. Shqetësimet e kroatëve lidhen me respektimin e plotë të të drejtave të minoriteteve,

bashkëpunim të plotë dhe pa kushte me Gjykatën e Hagës për krimet e luftës dhe anulimin e një ligji serb që e përjashton këtë vend nga juridiksioni ndërkombëtar për krimet e luftës. Por në Beograd janë të bindur se bllokimi kroat bazohet vetëm tek motivet politike të përditshme. Sipas analistëve dhe zyrtarëve serbë, vetëm kështu mund të shpjegohet kjo bllokadë, ndërkohë që 27 vendet e tjera të BE-së kanë dhënë dritën jeshile.



LAJME SHKURT

Arrestohet një nga atentatorët e kërkuar të masakrës së Parisit

Një nga të shumëkërkuarit për masakrën e Parisit, Mohamed Abrini është arrestuar dje. Abrini ishte në listën e personave më të kërkuar në Europë që kur ishte identifikuar në një video si personi që ndodhej në makinë me Salah Abdeslam 11 nëntorin e kaluar, dy ditë para atentateve terroriste në kryeqytetin francez. Abrini, 31 vjeç, me kombësi marokene dhe shtetësi franceze, ishte i kërkuar i fundit i masakrës, që arriti t'i shpëtonte policisë. Ai u kthye gjithashtu në njeriun misterioz që shfaqej kudo, nga Siria në Paris, Bruksel e më pas zhdukë sërish. Vetë Salah u arrestua dy javë më parë në Bruksel, 4 ditë para atentateve vetëvrasëse në aeroportin dhe metrot dhe kryeqytetit belg. Dorëzimi i tij tek autoritetet franceze duket se do të kërkojë më shumë kohë nga sa parashikohet, të paktën një javë më shumë.



Ka rinisur kthimi i grupeve të emigrantëve nga Greqia në Turqi

Ka rinisur kthimi i emigrantëve nga Greqia në Turqi në orët e para të ditës së premtë. Grupi i parë i emigrantëve prej 202 personash arriti në Turqi të hënën, por që atëherë procesi kishte ngjetur, për shkak edhe të rritjes së minutës së fundit të kërkesave për azil në Greqi. Çdo person i deportuar shoqërohet nga një përfaqësues nga Agjencia Kufitare e BE-së. Një zëdhënës i Frontex tha se nuk ka pasur asnjë problem gjatë dërgimit të emigrantëve nga kampi për në port. Sipas marrëveshjes mes Bashkimit Europian dhe Turqisë, të gjithë emigrantët të cilët kanë hyrë ilegalisht në Greqi pas datës 20 mars do të kthehen nëse nuk do të aplikojnë për azil në shtetin helen ose nëse kërkesa e tyre refuzohet.



Edmond Doko



Edmond Doko: Koncerti, ja pse i riktheva kompozitorët shqiptarë

Dirigjenti rrëfen motivet e përzgjedhjes së kompozitorëve shqiptarë në një koncert të përmasave të mëdha

Tingëllimi origjinal i veprave të kompozitorëve shqiptarë do të përcillet këtë herë nga skena e madhe e Teatrit të Operës dhe Baletit në Tiranë. Pjesëve të kompozitorëve më të shquar si Thoma Gaqi, Tonin Harapi, Çesk Zadeja, do t'i bashkohen edhe zërat origjinalë të kompozitorëve të huaj si Edvard Grieg, Sergei Prokofiev, etj. Kompozitorët shqiptarë e të huaj do të interpretohen si një trup i vetëm, pohon

dirigjenti i këtij koncerti Edmond Doko gjatë provave. Koncerti që do të mbahet më 9 prill nga Orkestra Simfonike e Tetarit të Operës dhe baletit titullohet "Paralele muzikore". Ky koncert do të mbahet me pjesëmarrjen e solistëve Ardita Bufaj në piano dhe Gëzim Bulçari në violinë.

"AUTORËT SHQIPTARË JANË TË DENJË SA ATA EUROPIANË"

Gjatë provave, dirigjenti Edmond

Doko rrëfen motivet e përzgjedhjes së kompozitorëve shqiptarë në një koncert të përmasave të mëdha. "Thjesht për të provuar që autorët shqiptarë në pjesën dërrmuese janë po kaq të denjë sa dhe autorët europianë. Prandaj dhe qëllimisht programi është ndërtuar si garë apo ballafaqim i këtyre veprave. Për shembull një valle simfonike e Edvard Grieg me një valle simfonike të Thoma

Gaqit", theksoi dirigjenti Doko. Në programin e koncertit përfshihen veç të tjerash interpretimi nga muzika e Sergei Prokofiev i Gëzim Bulçarit në violinë, si dhe "Romanca për piano dhe orkestrë" e Tonin Harapit që do interpretohet nga pianistja Ardita Bufaj. Koncerti do të vijojë edhe me kompozimet "Vajzat e qytetit të gurtë" të Çesk Zadesë, si dhe Suita nr.1 nga baleti "Hitushja".

MINISTRJA GJERMENI

"Trashëgimitë kulturore në Gjirokastrë, lehtësisht të vizitueshme"

Ministria e Zhvillimit Urban, Eglantina Gjermeni tha dje nga Gjirokastra se "bukuritë e trashëgimisë kulturore të Qytetit të Gurtë janë lehtësisht të aksesueshme dhe të vizitueshme". Dhe kjo falë zbatimit të projekteve të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, deklaroi Gjermeni për mediat. "Ky qytet është përfshirë edhe në projektin më të ri të Bankës Botërore për urbanizimin

e qyteteve të Jugut të vendit, që pritet të zbatohet përgjatë 5 viteve në vijim. Ndërkohë, gjatë vizitës time në Gjirokastrë u njoha edhe me punën që po bëhet për hartimin e planit të përgjithshëm vendor, i cili përfundon së shpejti, plan i cili bashkë me planet e 25 bashkive të tjera financohet nga qeveria shqiptare", tha ministria, e cila inspektoi këtë të premtë projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit

të Rajoneve në qytetin e Gjirokastrës. Sipas të dhënave zyrtare nga MZHU, në bashkinë Gjirokastrë për vitin 2014-2016, nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve janë alokuar rreth 904.686.420 lekë, për zbatimin e shtatë projekteve. Katër prej tyre kanë përfunduar, dy janë në fazë zbatimi, ndërsa rikonstruksioni i bulevardit "18 shtatori" është në fazë prokurimi.

Shqipëri-Itali

Vjen ekspozita e qyteteve të lashta shqiptare


Edhe pak ditë na ndajnë nga konferenca 100-vjet gërmime italo-shqiptare. Më datë 12 të këtij muaji, ora 18.00, në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar, nis konferenca dhe përirimi i ekspozitës "Qytete të Lashta dhe peizazhe të Shqipërisë". Kjo ekspozitë paraqet rezultatet kryesore të bashkëpunimit italo-shqiptar në fushën e gërmimeve arkeologjike, me një histori shekullore. Ky event vjen nën organizimin e Institutit Italian të Kulturës dhe Ambasadës Italiane në Tiranë në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Muzeun Historik Kombëtar, Institutin e Arkeologjisë dhe Universitetet e Barit, Bolonjës, Chieti-t, Ferrara-s, Foggia-s dhe Macerata. Ekspozita do të qëndrojë e hapur nga datat 12 Prill-20 Maj 2016 në Sallën e Ekspozitave, në Muzeun Historik Kombëtar.

KONCERTI

Merita Rexha Tërshana sjell Beethoven në Universitetin e Arteve

Koncerti për piano e orkestrë 5, i njohur botërisht si "Emperor Concerto", koncerti i fundit në piano i Ludwig Van Beethoven, u shfaq dje me sukses, në ambientet e Akademisë së Arteve në orën 19.00. Në piano, luajti pianistja e mirënjohur Merita Rexha Tërshana, dirigjent Leonardo Quadri dhe Orkestra e Radiotelevizionit Shqiptar. Merita Rexha ka lindur në Tiranë ku filloi studimet për piano që në moshë të re. Pasi përfundoi studimet në Akademinë e Arteve, ndoqi kurse të specializuara në Gjermani. Ajo është një nga artistet më aktive në arenën muzikore shqiptare. Rexha ka luajtur si soliste me orkestrën simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar, Teatrin e Operave dhe Ba-

letit, Orkestrën e Akademisë së Arteve nën drejtimin e dirigjentëve të njohur shqiptarë dhe të huaj si Laurent Quinot, Leonardo Quadri, Zhani Ciko, Bujar Llapaj, Alqi Lepuri, Jetmir Barbullushi, Deniola Kuraja. Merita Rexha është shpallur fituese disa herë si "Interpretuesja më e mirë e vitit" në Festivalin e Muzikës së Re Shqiptare 1996 nga një juri e drejtuar nga kompozitori francez G.Boeuf. Ajo është nominuar tre herë si "Interpretuesja më e mirë e vitit" në çmimet Kult në vitet 2004,2006,2008 dhe është fituese e çmimit "Kult" për vitin 2009. Merita është pedagogje në departamentin e pianos në Universitetin e Arteve dhe që prej 2007 ajo mban titullin Pedagogje e Asociuar.



Merita Rexha Tërshana

PJESA E DYTË E KUJTIMEVE*(Vijon nga dje)*

Për Demir Kodhelin nuk di që të kish bërë kompromisa, por ay ish mbyllur në fshatin e tij, në Peqin. Ca kohë ish mësues, shumë kohë ish pa punë. Ish nënë vrejte të madhe dhe kish shumë zor të merrte leje ose të justifikonte ikjen e tij prej Peqini. Ndofta Zogu e kish marrë vesh që Demiri kish qënë në Moskë. Papunsia dhe ndjekja e kishin tronditur moralisht. Me t'u takuar me mua, kërkoj të lejohej të dilte nga Shqipëria e të jetonte në emigracion i ndihmuar me të holla prej nesh, dhe tregoj interesim shumë të pakët në "Vijën e Re" e në çdo punë.

Përsa i përket mënyrës së punimit në konditat e ekzistencës legale Ali Kelmendi dhe Tajar Zavalani kishin dhënë dy shembëlla të kundërta. Aliu mbante kontakte me shokët kryesorë me të cilët bisedonte gjithë çështjet dhe jepte udhëzimet, dhe nga ana tjetër, për të humbur gjurmat kultivonte miqësira me borgjezë dhe me njerëz të regjimit me të cilët loste kumar. Kumari i ecte se i kish gishtrinjtë shumë të shkathëta, siç më kish thënë vetë. Tajar Zavalani nga ana tjetër, pëlqente t'a vinte vehten "in the lime-light" siç thonë amerikanët, d.m.th. t'a vinte vehten në dritën e reklamave. Me shkrime, përkthime, fjalime ay i bënte njëkohësisht vehtes reklamë si njeri i ndritur dhe i opozitës. Këtë ekstravagancë ay mund t'a bënte në sajë të miqësive të shëndosha që ay kish ndër bejlerët si bej vetë, dhe si burri i një bejleresh. Kjo rrugë e shpuri në oportunitizëm dhe e bëri të mos interesohet në asnjë mënyrë për punët e organizatës. Për këto arsye Kominterni më kish këshilluar t'a përdornja me kujdes; për këto arsye organizata e Korçës e mbante si komunist salloni dhe e përdorte me intelektualët dhe për përkthime.

Rruga e Aliut ish rruga që kisha vendosur të marr si shembëll, me përjashtim të kumarit i cili nuk e shpëtoj Alinë, me gjith vreset e asaj lodre, nga internimi. Në vënt të kumarit zgjodha artin e cila më bëhej e mundur nga që kisha motrën artiste.

Pra eksperiencia e së kaluarës e shokëve që kishin hyrë ilegalisht në Shqipëri, niveli i ulët i moralit politik të popullit, terrori i Zogut, si dhe vetë programi dhe taktika e "Vijës Re" diktonin nevojën që shokët që ktheheshin tani nga Moska, Aliu edhe unë, të hynim ilegalisht në Shqipëri dhe të punonim mundësisht sa më gjatë në konditat e ekzistencës legale.

KONDITAT E MIJA TË EKZISTENCËS LEGALE.

Unë kisha kondita më të mira se Ali Kelmendi për punë në konditat e ekzistencës legale. Aliu kish të kaluarën e tij në Shqipëri që e pengonte. Në aktivin e tij kish vetëm miqt e bixhozit. Në Komintern më kishin thënë se ata besonin që unë kisha kondita të mira për punë në Shqipëri. Edhe e vërteta kështu ish. Unë isha fort pak i njohur për lidhjet e mija me puntorinë. Asnjeri s'kish marrë vesh për qëndrimin t'im në Moskë. Qëndrimi i im 6 vjet në Bashkimin Sovjetik (1930-1937) më kish hequr nga qarkullimi, si me thënë, dhe pra kish ndihmuar të ma harrojnë të kaluarën t'ime n'Amerikë e n'Austri, dhe kish dhënë përshtypjen që unë isha bërë pasiv. Lëvizjet e mija në Francë, 1935-1936 i kishja mbajtur të fshehura – këto pa fjalë, janë avantazhe relative.

Isha intelektual nga familje intelektuale (vëllaj inxhinier-agronom, një vëlla tjetër profesor, një motër artiste). Edhe nënën e kisha nga një familje intelektuale (doktorash). Me qënë se hajdutllëku zyrtar në regjimin e Zogut ish kulmi i nderçmërisë, integriteti personal i antarëve të familjes s'ime ish e vetmja arsye pse mund të shiheshin me sy të qetë prej këtij regjimi.

Gjatë viteve 1937 e deri sa ardhë të më arrestojnë (7 Maj 1942, 2 ditë pasi u vra Qe-



Koço Tashko majtas në fund

KOÇO TASHKO:

AVANTAZHET E SEKRETIT TË 6 VITEVE TË MIA NË BASHKIMIN SOVJETIK

Pjesa e dytë e kujtimeve për fillesat e komunizmit/ Tashko: Qëndrimi i im në Bashkimin Sovjetik më kish hequr nga qarkullimi, si me thënë, dhe pra kish ndihmuar të ma harrojnë të kaluarën t'ime n'Amerikë e n'Austri, dhe kish dhënë përshtypjen që unë isha bërë pasiv...

I kthyer në Shqipëri pas 18 viteve emigrim, sipas një vendimi të marrë në Moskë nga Kominterni, Koço Tashko do të niste aktivitetin e tij për ngritjen e celulave të para komuniste, aktivizimin e masave për demonstrata, etj. Në pjesën e dytë të kujtimeve të tij për këtë periudhë shkruar në vitin 1948, (pjesën e parë e botuar dje) Koço Tashko rrëfen gjitha angazhimet e tij dhe terrenin e vështirë për komunistët në Shqipërinë e mbretit Zog. Në këtë pjesë të dytë të kujtimeve ku zbërthehen shumë ngjarje e personazhe, Koço Tashko bën edhe një skaner të jetës politike në Shqipërinë e fund viteve '30.

mal Stafa) munda të kamufloj punën t'ime me organizatën e Korçës e me grupet dhe individët, në të gjithë qytetet me rëndësi të Shqipërisë (veç Gjinokatrës) duke u paraqitur si organizator i koncertave të motrës s'ime. Njëkohësisht mbanja edhe një qen të bardhë me të cilin dilnja në Pazar e në kafenatë. Nuk hoqa dorë nga vizitat me rast festash fetare ndër njerzit që mund të theshnin fjalën e mirë, dhe veçanërisht nga vizitat nëpër zyrtarët për punët e organizimit të koncertave. Kështu mbuloja gjurmat.

Passi ardhë të më arrestojnë kërkova nga

Kamber Qafmolla, i cili mbante një pozitë në policinë fashiste por simpatizonte me ne dhe mori pjesë në Konferencën e Pezës, të hetojë dosjen t'ime në polici. Ay pa jo vetëm dosjet e policisë, por edhe ato të xhandërmarisë dhe të organeve të tjera të sigurimit dhe më tha që asgjë nuk figuronte kundër meje gjer dy a tre ditë para se të vendosej arrestimi im nga fashistët. As në kohën e Zogut s'kish patur gjë. Hyra pra në dosjet e Ministrisë Brëndëshme vetëm me trathëtinë e Ludovik Nikajt të cilin e kisha patur në celulen t'ime më 1941-1942.

Edhe Gjergj Bubani (spiu i gjithë regjimeve, Drejtor i Radio Tiranës, dhe ndezës i intrigave midis artistëve) që vinte shpesh në shtëpinë t'onë për punët artistike të motrës s'ime u habit kur ardhë të më arrestojnë. Ay i tha motrës s'ime: Kërkoni nga gjithë anët të kapnin një nga krerët e komunistave dhe unë këtë e kisha parasysh pothuaj përdit. Ay shaheshe me mua për çështje në lidhje me komunizmin, rinin dhe Bashkimin Sovjetik, por, si duket, kurrë nuk i shkoj në mënt të më dyshojë për tjetër gjë veçse për radikalizëm salloni; d.m.th. më mori për një person si ay vetë që ngjente në çdo çërvish ideologjik, ose si Tajar Zavalani.

Pa fjalë që kjo mënyrë punimi kish edhe anën e keqe. Ndhimonte plogëshinë t'ime gjenerike dhe punës s'ime i jepte pa dashjen t'ime një tornurë diletantizmi. Kjo u jepte shtek edhe grupeve të më luftojnë si njeriu i Koço Kotës. Qeni i bardhë ish bërë për grupet kundërshtarë në them muhabeti dhe shkak për kritika personale e për luftë pa princip; u bë armë në duart e krerëve të grupeve kundërshtarë që të incitojnë (nxitin) të rinjt e tyre të më vrasin. Për këtë do flas më von.



Faksimile të kujtimeve të Koço Tashkos të shkryara 1948



GJËNDJA POLITIKE NË SHQIPËRI MË 1937.

Të kisha tani përpara meje "Buletin e Bardhë" që nxirte organizata e Korçës në Korçë më 1937-1938, do të isha më mirë në gjënde të pikturonja gjënden në Shqipëri në kohën kur unë mbrita atje.

Dihet që më 1934 kish patur një konflikt midis Musolinit dhe Zogut. I pari mudohej t'a nënshtronte Zogun e të pregatiste okupacionin. I dyti pranonte nënshtrimin e interesave kombtare por jo të prerogativave të tija personale si mbret. Për nënshtrimin e interesave kombtare si për shëmbëll koncesionet vajgu- rorë, bankare, bujqësore etj, ay kërkonte rryshfete dhe huara të mëdha për të forcur pozitën personale në Shqipëri. Ky pelivanllëk me doemos do të dështonte dhe mbarimi do të ish okupacioni.

Më 1934 (më duket nga Korriku) Muso- lini zbarkoj marinarë në Durrës. Gjënda ndërkombëtare nuk e favorizoj Musolinit, i cili u tërhoq. Zogu mori masa shantazhi kundër Musolinit që në të vërtetë ishin blote sa kohë që ai i zgjatë dorën Musolinit dhe nuk mund të gjente rryshfete gjëtkë. Ay më 17 Shtator 1934, me anë shkëmbimi notash midis përfaqësit të Zogut dhe Përfaqësit të Bashkimit Sovjetik, "vendosi marrëdhë- njëkohësisht ay bëri syn e mbyllur e ndofta inkurajoj puntorët e ndërmarrjeve italiane të bëjnë greva kundër patronëve italianë. Këto greva ishin të forta në Kuçovë. Lejoj shtypin Francez, bile edhe të majtën gjer te "Populair- re", të hyjë në Shqipëri që të krijohet një garh midis rinis intelektuale shqiptare dhe tenta- vive të Musolinit për t'a bërë për vehte rininë. Njëkohësisht Zogu e reklamonte veten si liberal e përparimtar përpara kësaj rinije. In- tektualët e Shqipërisë ahere digjonin Radio Toulouse-in po thua lirisht, por puntorët dig-

jo- ni n Radio Moskë në fshehtësi. Njëkohësisht Zogu u mundua t'i kanali- zojë lëvizjen e Rinisë dhe të puntorisë duke krijuar shoqëria jashtshkollore e parashtarake dhe duke lejuar disa pak sindikata (me ndërhyrjen të Albert Thomas- it, i Drejtorisë së Punës pranë Lidhjes së Kombeve). Të gjitha këto shoqata dhe sindikata i kish regulluar me anën e Statuteve të tyre të jenë nën kontrollin e tij. Sidoqoftë, këto manevra liberale të tij formonin një teren për punë nga ana e jonë".

Në këtë mes Musolini nuk ndenji duar kryq. Ay nuk i dha para Zogut, përkundër

centralizonjës i Zogut dhe të inkurajuar prej imperializmit italian. Kryengritja e Fierit e tronditi dhe "i vuri mën" Zogut, nën presionin e Musolinit. Ay shtypi lëvizjen puntore të Kuçovës dhe të gjithë lëvizjet antiitaliane. Nxori ligjin që dënonte rreptësisht kritikën kundër politikës së jashtëme të Zogut, d.m.th. kundër politikës me Italinë. Nga ana tjetër vrau Riza Cerovën dhe burgosi, terrorizoj dhe torturoj me mijra kundërshtarë që i akuzonin se kishin di- jeni për lëvizjen e Fierit para se të pëlciste.

Pushkatoj 11 xhandarë. Më vonë më 1936, arre- stoj në Ko- rçë e gjetkë dhe internoj shumë in- tektualë komu- nista e të tjerë. Mori një hua të madhe nga Muso- lini të cilit i dha, në çkëmbim, shumë kon- cesione politike, eko- nomike dhe ushtarake që pregatinte, 7 Prillin. Shtetzgj shkolla por la je- zuitët të lirë.

Me gjith' atë, shtypin fran- ces Zogu nuk e ndaloj krejtë- sisht. Filloj të ndaloj Humanitë- në, e gazeta të tjera që nga e Majta e deri afër Qëndrës, por gazeta "l'Ordre" e Emile Burë- së e disa të tjera me tendenca të fa- vorshme për aleancën Franco- Sovjetike, vazhdoj të hyjë në Shqipëri deri në 7 Prill 1939. Profesori Francezë vazh- duan të qëndronin në Ko- rçë. Spionazhi Anglo- Amerikan vazhdoj të punojë ndër tërinjtë tanë që kishin bërë mësimë në shkollat amerikane e që kishin lidhje me institutin antimalarik, që nuk u pezullua, e me spionë si Mrs. Haslock, Hill e të tjerë. Influenca e Mrs. Haslock në Rininë e Elbasanit ish mjaft e madhe. Dhe shoqëritë e rinisë që ay kish krijuar nuk i çduku atje ku ishin të gjalla, si në Korçë.

Pikërisht rreth rinisë shqiptare tani po zhvillohej beteja midis Zogut dhe Musolinit. Ky i fundit i kish dërguar mikun personal të tij Xhiron, që të merrej vesh me Zogun, që ky fashist të bëhej organizatori i rinisë shqiptare, d.m.th. të bëhej fashizonjës i rinisë shqiptare dhe pregatitës me anën e rinisë, të okupacionit. Zogu e mbajti me premtine Xhiron për shumë kohë. Zogu vajti aqë lark sa në një fjalë të Frontit që mbajti (më duket më 1937) para parlamentit, foli në favor të riorganizimit të Rinisë në baza të reja. Kuptohet që bazat do të ishin ato të Xhiros. Por Zogu realizoj që koncedimi i Rinisë në duart e Xhiros desh të thesh që ay nga Mbret duhej ose të pranonte të losterolon që lojti Shefqet Vërlaci pas okupacionit, ose të ikte prej Shqipërisë. Viti 1937 dhe një pjesë e 1938-ës këtë kishte për problem kryesor.

Unë kisha marrë udhëzimin në Moskë, se në rastin që Zogu të më vërtetë trezikohej prej Musolinit me një zbarkim, ahere përpara okupacionit detyra e jonë do të ish të bënim një front të përbashkët me Zogun.

kërkonte pagim e borxheve. E dyta ay shpuri që të pëlciste kryengritja e Fierit. Në këtë kryengritje shokët komunist të ahershëm u deleguan të marrin pjesë si individë, pa program e pa masë e popullit, dhe pa fjalë pa dashur u bënë veglat e forcave motrice të lëvizjes që ishin disa bejlerë të prekur nga programi

Elseid Hysaj kërkohet nga ekipi Chelsea

Conte e ka shënjestruar shqiptarin si lojtarin ideal për krahun e djathtë të mbrojtjes së skuadrës angleze

Antonio Conte dëshiron Elseid Hysajn në skuadrën e tij të re. Trajneri italian është bindur se ai do të ishte lojtari perfekt për skemën e tij të zakonshme 3-5-2, apo edhe për atë 4-4-2. Mbrojtësi shqiptar ka shkëlqyer me Napolin ku pavarësisht emrave që ka pasur përballë në kampionatin italian apo në arenën ndërkombëtare, ai ka marrë gjithmonë vlerësime të larta. Hysaj ka kontratë me Napolin deri në vitin 2020, por Chelsea nuk e sheh aspak pengesë këtë fakt pasi ka bërë gati ofertën e parë prej 20 milionë eurosh, mjaftueshëm për të bindur skuadrën italiane ta lërë të lirë shqiptarin. Chelsea duhet të përballlet me konkurrencën e Bayern Munich, Atletico Madrid e Bayer Leverkusen, skuadra këto që janë të interesuara për shërbimet e mbrojtësit shqiptar



TRAJNERI CONTE

Conte dëshiron Hysajn për skuadrën e tij të re edhe për arsye se 22-vjeçari është ndër lojtarët e rrallë që mund të luajë në të dy krahët e fushës.

Ideja e trajnerit italian është që Hysaj të vazhdojë të luajë në krahun e djathtë, aty ku shqiptari jep më të mirën. Aktualisht, në krahun e djathtë të mbrojtjes luan kapiteni i

kombëtares serbe, Branislav Ivanovic, i cili ka qenë në qendër të kritikave për paraqitje të dobëta këtë sezon. Conte planifikon që serbin ta shfrytëzojë si qendërmbrojtës, të paktën edhe për një sezon, pasi në verën e vitit të ardhshëm atij i skadon kontrata me klubin londinez. Chelsea besohet të ketë qenë i interesuar për Hysajn edhe në korrik të vitit 2015, si një alternativë e krahut të majtë pas largimi të Felipe Luis, por për fatin e Napolit, londinezët vendosën për Baba Rahman. Për Hysajn tashmë duket se karriera e tij do të shkojë shumë më larg se Seria A. Pas ofertave nga klubet më të mëdha të Europës do të jetë e vështirë që Napoli të arrijë të mbajë shqiptarin. Sidoqë të përfundojë merkato Elseidi tashmë pret një hap tjetër të madh në karrierën e tij, kur kujtojmë se vetëm në sezonin e kaluar luante për një skuadër modeste si Empoli.

SERIA A

Massimiliano Allegri kërkon të thellojë krizën e Milanit

Sot në San Siro, Milan dhe Juventus do të përballen sërish në një sfidë shumë të rëndësishme për ecurinë e të dyja këtyre ekipeve në këtë sezon të Serisë A. Massimiliano Allegri do të rikthehet në stadiumin ku u bë i njohur si trajner me objektivin për të thelluar krizën e Milanit, edhe pse trajneri livornez e di që Juventusin e tij nuk e pret një ndeshje e thjeshtë. "Do të kthehem në një stadium ku jam ndër të shumtë mirë për vite me rradhë. Gjithsesi në dy sezonet e fundit jam ndër të gjithashtu shumë mirë edhe në Torino. Dua të fitoj kampionatin e dytë radhazi me bardhezinjtë sepse pavarësisht se çfarë thuhet nuk kemi fituar ende asgjë. Duhet të ruajmë përgëzimin. Ndeshja ndaj Milanit është shumë e rëndësishme për ne, ndërsa pas kësaj sfide mbeten edhe 6 takime të tjera për tu luajtur. Duhet të bëjmë një paraqitje të shkëlqyer. Milani lufton për një vend në Europa League kurse ne duhet të mendojmë që

nga kjo ndeshje mund të varet një pjesë e mirë e sezonit". Në vijim Allegri konfirmoi mungesën e Dybala, ndërkojë që theksoi se Rugani do të luajë titullar ndaj kuqezinjëve pasi është një lojtar që i ka të gjitha mundësitë për të bërë mirë. Në krahun tjetër trajneri i Milanit Sinisa Mihajlovic përcaktoi objektivat e skuadrës së tij ndërkohë foli edhe për të ardhmen, pa anashkaluar

sfidën e kësaj të Shtune ndaj Juventusit. "I detyrohemi tifozëve tanë dhe drejtuesve ta përfundojmë kampionatin në vendin e 6-të dhe të fitojmë Kupën e Italisë. Është normale që e ardhmja ime të jetë në diskutim, dhe nëse do të bëjmë keq në sfidat e ardhshme është gjithashtu mëse normale që të shkarkohem nga detyra. Gjithsesi për një gjë të jeni të sigurtë unë do të jap gjithmonë maksimumin



nga vetja në këtë aventurë. Ndaj Juventusit do të jetë një ndeshje e vështirë në të cilën ne duhet të luajmë si në atë periudhë kur gjërat shkonin mirë".

TRANSFERIMI

Bayern Munich 50 mln euro për Marchision



Claudio Marchisio në radarët e Bayern Munchen. Ekipi bavarez duket se është i vendosur në transferimin e mesfushorit të Juventusit. Madje, vetë trajneri i ardhshëm i Bayern-it Carlo Ancellotti që e ka vendosur lojtarin në krye të listës të lojtarëve dhe kërkon ta ketë në dispozicion për sezonin e ardhshëm. Marchisio ka një kontratë me bardhezinjtë që përfundon në Qershor të 2020. Pavarësisht kësaj drejtuesit e klubit gjerman janë të gatshëm të ofrojnë 50 milionë Euro për shërbimet e futbollistit. 30-vjeçari e sheh të ardhmen e tij tek Juventusit dhe ëndrra e tij është të marrë shirtin e kapitenit. Ndërkohë që nga ana tjetër detyrja drejtuese e klubit bardhezi Agnelli-Marotta nuk kanë ndërmend të heqin dorë nga futbollisti 30-vjeçar, pavarësisht se oferta e bavarezëve është tunduese.

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Pensioni për familjen e Dr.Florit ja përgjigja e Ramës për Mamaqin
- VIDEO/ Nusia ofendon vjehrin në mes të dasmës, ja ç'ndodhi...
- Daja i Idës për Report Tv: Admini kreu vrasje të trefshhtë
- Hani i Hotit, digjen makinat e drejtorit e inspektorit të doganës
- Sherr në Kuvend, Paloka godet Braçen në foltore, ndërhyrjen garda
- Serviset e makinave, jo më pa drejtues ligjor, ja kushtet që duhen
- Rrëzimi, helikopterëve u mungojnë 2 kutitë e quajtura "Kite" të servisit
- Shkodër, sekuestrohen 19 makina luksoze të vjedhura, pranga tregtarit
- FOTO/ Piloti Della futuroi për të fundit herë mbi vendlindjen e tij
- Helikopteri, Berisha merr videon bllof e kerkon komision hetimor

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Zgjedhja e Trump? Rama: Kërcënim për marrëdhëniet SHBA-Shqipëri
- Gardisti para Gjykatës: E vrava gruan se nuk më respektonte
- Tanderi, Braçe: Kallëzim penal për Berishën e disa portale, ja e vërteta
- Marjani: Gjykatat të mos bëhen pengesë për kreditë e këqija
- Pensioni për familjen e Dr.Florit ja përgjigja e Ramës për Mamaqin

VIDEOET MË TË KLIKUARA DJE

Sherr në Kuvend, Paloka godet Braçen në foltore, ndërhyrjen garda

Rrëzimi i helikopterit, Report Tv mëson dëshminë e ushtarakut


Bllofi me videon e helikopterit që u rrëzua në liqenin e Shkodrës

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZHI IDITES

A besoni që ILDKP do të zbulojë ku fshihen paratë e politikanëve shqiptarë?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1.542 | 275.203
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

FJALËKRYQESH

NGA Kadri VOKOPOLA



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 36 KUTI

12x17 grid for the crossword puzzle.

HORIZONTAL

- 1. Gjysmë tabelle. -Eshhtë muzikë dasme...

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Grid with answers for the crossword puzzle.

- 12. Janë legjenda. -Fillojnë litrat. -Campron rregjorisore...

- të shenja 11. Flet për kreshniket. -Fatale kur nuk fle...

FJALËKRYQI SPORTIV

17x17 grid for the sports crossword puzzle.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Grid with answers for the sports crossword puzzle.

HORIZONTAL

- 1. Janë fise pa fe. 3. Safely... në pistë. 6. Të fundit në tender...

- 31. ... King Cole 33. Eshhtë nusja me vello. 34. Ylli i Hollywood-it...

VERTIKAL

- 2. Shoqëronin Panin. 3. Mantolo ish as i Inter. 4. Conte trainer...

SUDOKU

PLOTESONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

9x9 Sudoku grid.

9x9 Sudoku grid.

HOROSKOPI

DASHI

Sot do kuptoheni me mire me partnerin tuaj ju te dashuruarit dhe marrëdhënia me te do jete me e qendrueshme...

DEMI

Mos u tregoni materialiste sot juve qe jeni ne nje lidhje sepse do e perkeqesoni marrëdhënien me partnerin dhe shume shpejt mund te vije fundi...

BINJAKËT

Dite e favorshme per dashurinë do jete kjo e sotmja per ata qe janë ne nje lidhje. Gjithçka ka per t'u ecur ashtu si keni dashur...

GAFORRJA

Dite impulsive do jete kjo e sotmja per ata qe janë ne nje lidhje. Ne disa momente nuk do arrihi dot ta kontrolloni veten dhe mund te fillojnë debatet...

LUANI

Jeta juaj ne çift do lere shume per te dëshuar sot. Me partnerin keni për te pasur edhe disa konflikte për gjera elementare dhe pa ndonjë rëndësi te madhe...

VRIGJËRËSHA

Dite me ulje dhe ngritje ka për te qene kjo e sotmja për ata qe janë ne nje lidhje. Mundohuni te tregoheni me te kujdeshem me fajlet dhe veprimet...

PESHORJA

Mos u tregoni impulsive sot juve qe jeni ne nje lidhje pasi situata mund te perkeqesohet tej mase. Sa me tolerante dhe te hapur te jeni ag me mire do jete. Beqaret nuk do ndihen ende gati për te filluar nje lidhje...

AKREPI

Do jeni shume xheloze për partnerin tuaj sot dhe kjo do e rrezikojë jashhtëzakonisht shume atmosferën. Debatet do jete te pafundme. Beqaret do pëlqejnë një person, por ai do ketë dikje tjetër ne mendje...

SHIGJETARI

Nëse nuk tregoheni te matur me partnerin dhe thoni gjera qe mund ta lëndojnë atë, keni për te pasur probleme dhe vështirësi te mëdha. Beqaret duhet te degjohen zemërën e tyre ne mënyrë qe te ndihen te plotësuar. Për te tjerët mos mendoni për asnjë cast. Me financat do keni vështirësi te mëdha për shkak te shpenzimeve te jashtëzakonshme qe keni kryer se fundmi.

BRICJAPI

Do ndiheni mjaft mire pranë atij qe dashuronit sot dhe mund te flisni hapur për çdo gjë. Disa pengje te se shkuare do i zgjidhni dhe do jete me te qete. Beqaret do emocionohen pafund nga një propozim qe do marrin dhe nuk do mundin dot te refuzojnë. Gjendja e te ardhurave ka për te qene e kënaqshme. Do arrihi te kryeni te gjitha shpenzimet e ëndërruara.

UJORI

Do ndiheni gjithë kohës mire sot ju te dashuruarit dhe nuk do keni për çfarë te qaheni. Partneri do ju mbaje gjithë kohës ne pëllymbe te dorës. Beqaret as nuk do mendohen dy here dhe do i pranojnë propozimet qe do ju bëhen. Jeta do ju ndryshoje menjëherë. Financat do jete te mbrojtura ne çdo moment kështu qe as mos u shqetësoheni për asgjë.

PESHQIT

Sot gjerak nuk do ecin sipas planeve për juve qe jeni ne nje lidhje. Do keni here pas here debate e konflikte dhe nuk do jeni te qete. Beqaret ne momentin qe me pak e presin do realizojnë disa takime interesante te cilat do ua ndryshojnë përgjithmonë rutinën. Te ardhurat do jete akoma me te mira se me pare. Përfitonit edhe për te shlyer disa borxhe te hershme.

PËRGJIGJE

Grid with answers for the horoscope section.

SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

15x15 grid for the cryptogram puzzle.

Abonohu!



[SHQIPTARJA.com]

origjina e lajmit...

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:



POSTA SHQIPTARE

Tel: 042 375 598 ; 04 237 55 98 ; Cel: 066 20 17 771
 abonime@postashqiptare.al



AGJENCIA E ABONIMIT TË SHTYPIT

Tel: 04 422 11 08 ; Cel: 066 20 47 825
 arben.trenova@yahoo.com



ADRION LTD

Tel: 04 22 40 018 ; Cel: 069 40 36 824
 sales@adrionltd.com